



Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.12.2019, Ora 16.00

Drejtojnë mbledhjen:

**Damian Gjijnuri dhe Rudina Hajdari – bashkëkryetarë të Komisionit të
Posaçëm të Reformës Zgjedhore**

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me shoqërinë civile dhe përfaqësues të partive politike për të diskutuar për draftin e dytë të ekspertëve

Marrin pjesë:

Damian Gjijnuri, Rudina Hajdari, Vasilika Hysi, Blerina Gjylameti, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Arben Elezi, Myslim Murrizi, Korab Lita, Nimet Musaj, Adriatik Alimadhi dhe Adnor Shameti.

Mungojnë:

Klotilda Bushka

Të ftuar:

Valentino Mustaka – Kryetar i Partisë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane

Ilia Gjoka – Këshilltar i Partisë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane ABDE

Oltion Kordha – Kryetar i Partisë Shqipëria e Re

Ermal Arapi – Përfaqësues i Aleancës Arbnore Kombëtare

Gjergj Prifti – Kryetar i Partisë LIBRA

Gjergji Koja – Partia Socialiste e Moderuar

Mynrid Guri – Partia Socialiste e Moderuar

Eduard Abazi – Partia Aleanca Demokratike

Gaqo Apostoli – Partia Aleanca Demokratike

Kostaq Papa – Partia Emigracioni Shqiptar PESH

Edmond Kasmi – Subjekti G99

Kujtim Muça - kryetar i Partisë Demokratike për Integrim dhe Prosperitet

Idajet Beqiri – Uniteti Kombëtar

Kristaq Kume – Instituti Shqiptar per Zhvillim të Sistemit të Zgjedhjeve

Premto Gogo – KRIIK

Erjon Tase – Përfaqësues i Akademisë së Studimeve Politike

Gerta Meta – Shoqata per Kulture Demokratike (SHKD)

Gazmend Agaj – Shoqata per Kulture Demokratike (SHKD)

Rigers Bena – Shoqata per Kulture Demokratike (SHKD)

Mirela Roshi – Rrjeti i Grave - Barazi në Vendimmarrje Women's Network Equality

in Decision Making

Afrim Krasniqi – Instituti i Studimeve Politike ISP

Mandrit Komolli – Instituti Demokratik Amerikan NDI

Andi Tepelena – Fondacioni Albania

Brizilda Gjickondi – Fondacioni Albania

HAPET MBLEDHJA

Damian Gjicknuri – Mirëmbërëma të gjithëve!

Faleminderit që keni ardhur pas njoftimeve të njëpasnjëshme në lidhje me këtë mbledhje!

Fatkeqësisht, ju e dini se kjo mbledhje ishte parashikuar për një datë tjetër, por në datën 26 nëntor vendi u godit nga një tragjedi, ndaj e kishim të pamundur ta zhvillonim atë ditë. Megjithatë, mendojmë se kjo kohë, pas traumave që kaloi pjesa më e madhe e shqiptarëve, është edhe moment i mirë për të rifilluar punën me Komisionin e Reformës Zgjedhore, duke e nisur aty ku e lamë, pra te dëgjesa me përfaqësuesit e partive politike jo të përfaqësuara në Kuvend dhe me anëtarë të shoqërisë civile në lidhje me projektet që kemi paraqitur në Komisionin e Reformës Zgjedhore për sa u përket kapitujve që prekin çështjet e administrimit zgjedhor, pra çështjet e administratës zgjedhore në të gjitha nivelet.

Do t'ju lutesha që, për hir të ekonomizimit të kohës dhe nisur nga praktika që kemi themeluar me njëri-tjetrin që komentet tuaja duhet të vijjnë me shkrim, sepse do t'ju jepet mundësia që brenda një kuadri minutazhi prej shtatë minutash, që besoj se është i mjaftueshëm, në mënyrë të përqendruar të jepen komente, vërejtje, propozimet tuaja, të cilat, patjetër, do të vijjnë edhe me shkrim, në mënyrë që ekspertët e komisionit dhe ky i fundit t'i shikojnë me vëmendje për t'i adresuar.

Kemi menduar që kësaj radhe ta fillojmë me përfaqësuesit e partive politike, meqenëse seancën e kaluar e filluam me shoqërinë civile, qoftë edhe për të pasur një lloj trajtimi të barabartë dhe për të pasur një lloj alternimi. Sa herë të kemi dëgjesa të tjera, do t'i alternojmë që një herë të flasin përfaqësuesit e shoqërisë civile, një herë partitë politike.

Pa humbur kohë, do të dëshiroja të fillonim me përfaqësuesit e partive.

Unë po i marr sipas listës me radhë. Në qoftë se nuk janë prezentë, kuptohet që radha do të kalojë tek tjetri.

Nga Partia Socialiste e Moderuar kemi zotin Gjergj Koja, të cilin nuk e shoh këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Apo erdhi Gjergji? Po kaloj tek tjetri, meqenëse Gjergji sapo erdhi.

Nga partia "LIBRA" kemi zotin Gjergj Prifti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjergj Prifti – Përshëndetje!

Në fakt, i lexuam amendamentet dhe shikojmë që ka një tentativë që Komisioni Zgjedhor të jetë i pavarur. Kjo është diçka pozitive, por ne mendojmë që mënyra se si zgjidhen këta anëtarë, pra zgjidhen nga Kuvendi, lë për të dëshiruar. Ne mendojmë se do të ishte mirë që zgjedhja e këtyre anëtarëve të bëhej me short, siç u zhvillua edhe shorti i sotëm, po themi, me gogla për KED-në. Pra, të jetë e njëjta procedurë edhe për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Zgjedhor.

Një element tjetër që do të doja ta diskutoja, ishte edhe përfshirja e administratës publike në zgjedhje, si komisionerë zgjedhorë me një mandat që të ketë statusin e nëpunësit civil, në mos gabo, trevjeçar. Për mendimin tim, për të mos ia lënë këtë barrë qeverisë, do të ishte e arsyeshme që mandati të ishte dhjetëvjeçar. Pra, këta anëtarë të kishin një mandat dhjetëvjeçar si nëpunës civilë.

Vetëm këto dy pika do të doja të diskutoja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, eksperiencë. Pra, statusin e nëpunësit civil ta kenë prej dhjetë vjetësh, jo prej tre vjetësh.

Këto dy çështje kisha. Pjesa tjetër është më shumë teknike dhe nuk kemi pse...

Damian Gjikhuri – Ishit shumë konçiz, ju falënderoj!

Fjalën e ka tani zoti Gjergji Koja, meqenëse në momentin kur unë e përmenda ai sapo hyri në sallë dhe nuk ishte i përgatitur.

Gjergji, shtatë minuta maksimumi, sepse kështu kemi vendosur për ekonomizim të kohës.

Gjergji Koja – Faleminderit, zoti kryetar!

Gjithashtu, falënderoj të gjithë autorët e draftit të amendamenteve në lidhje me Kodin Zgjedhor. Natyrisht, ka një tentativë serioze për të sjellë një legjitimitet në drejtim të menaxhimit të procesit të votimit dhe të numërimit të votave. Padyshim, nuk ka amendamente të shkëlqyera dhe 100% të pranueshme nga të gjithë, por unë do të doja të ndalesha te një pikë, te një moment që ka tërhequr vëmendjen: personat ose personazhet, komisionerët, ose quajini si të doni, që do të merren me menaxhimin ose, më saktë, me administrimin e numërimit të votave, janë ata që janë trajnuar deri tani nga KQZ-ja, apo do të hapet një modul i ri dhe do të vijë një erë e re për sa u përket personave që do të trajnohen njëherë e mirë dhe do të kenë këtë status? Këtë merak kisha, sepse kjo do të thoshte shumë për sa i përket moskundërshtimit të mëtejshëm të numërimit të votave nga cilado palë politike, nga cilado parti e kështu me radhë.

Faleminderit!

Damian Gjikhuri – Siç e shikoni, në tekst bëhet fjalë për persona të cilët do të trajnohen nga KQZ-ja nëpërmjet një procesi, i cili do të përfshijë të gjithë nëpunësit civilë, plus çdo njeri i cili plotëson kriteret: është student i vitit të katërt në shkollë të lartë dhe çdo person tjetër, i cili ka arsimin përkatës, i cili mund të bëhet pjesë e skemës së trajnimit. Kjo do të thotë që do të pajiset me një certifikatë, e cila është bazë për të qenë komisioner apo qoftë edhe numëruar votash. Ky është një sistem totalisht i hapur, i përzgjedhur me short dhe brenda një qarku të caktuar, ku disa persona do të përzgjidhen nëpërmjet shortit, por me kushtin që duhet të kenë certifikatën si persona të trajnuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si dhe nuk duhet të kenë kryer shkelje të mëparshme në proceset zgjedhore.

Nga kjo pikëpamje, ne dhe ekspertët mendojmë (sepse ky është një projekt i paraqitur nga ekspertët) që arrihet departizimi dhe depolitizimi i komisioneve zgjedhore në të gjitha nivelet, përfshirë edhe numërimin e votave. Kjo është pak a shumë. Pra, bëhet fjalë për trajnimin tërësor të këtyre kategorive: të gjithë nëpunësit plus çdo person, qytetar, që plotëson kushtet dhe aplikon në këtë skemë.

Vijojmë me zotin Kostaq Papa nga Partia Emigracioni Shqiptar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është?

Vijojmë me zotin Ilia Gjoka nga Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është as ky?

Vijojmë me zotin Edmond Kasmi nga subjekti “G99”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është.

Vijojmë me zotin Dhimitër Muslia nga kristiandemokratët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është?

Vazhdojmë me zotërinjtë Eduard Abazi dhe Gaqo Apostoli nga Aleanca Demokratike, por do të flasë vetëm njëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Abazi – Së pari, ngushëllime familjarëve të viktimave! Shpreh solidaritetin me të gjithë shqiptarët për atë që ndodhi, madje shpreh se duhet të jemi në situata të vështira krahas njëri-tjetrit.

Unë i kam lexuar me vëmendje të gjitha rekomandimet dhe ndryshimet që propozoni, ndaj do të përpiqem të jem sa më racional duke u ndalur te pikat, ku unë gjykoj se ka nevojë të korrektohet, të shtohet apo të rregullohet diçka.

Duke filluar nga pikat e para, te komisioneri i zgjedhur, ku, midis të tjerave thoni se duhet një mandat shtatëvjeçar, për fjalën “i ripërtëritshëm”, më duket se kështu e keni, duhet gjetur një term ndoshta i mbështetur në fjalor, që mund të jetë përsëritje përtej ripërtëritjes. Sipas fjalorit nuk shkonte ripërtëritje.

Në pikën 2, ku ju thoni, midis të tjerave “ish-funksionarë politikë”, meqenëse thoni që po heqim dorë nga administrimi politik, duke filluar nga kupola e administrimit të zgjedhjeve, është mirë të mos jetë e veçuar edhe ish-politikë, por duke mos ia hequr të drejtën askujt të jetë pjesë e garës. Madje, kriteret duhet t’i përcaktoni më tej se kush do të jenë ata që e kanë tagrin për të qenë pjesë e garës, ndërsa se si do të zgjidhen është problem tjetër.

Te pika 5 më poshtë thoni: “Një anëtar aktiv i ndonjë partie politike ose nëse”. Pra, do të jetë pjesë e garës ose i hiqet e drejta, ose ka interesa private të dukshme ose të njohura. Unë mendoj dhe gjykoj që ka pak dallim ndërmjet një funksionari politik nga një person tjetër që është marrë me politikën, pushtetin dhe ka qenë pjesë e administrimit edhe kohë më parë.

Në nenin 15 (po i bie shkurt që të mos zgjatem) thoni se nuk duhet të jetë pjesë e kandidimit një person që ushtron funksione edhe si gjyqtar. Ne ku t’i gjejmë që të ketë mundësi dikush që të shkëputet nga sistemi, sepse bëhet fjalë vetëm për një person që të jetë edhe me tregues të tillë, madje të ketë kaluar edhe vetingun?! Nuk kemi pse e kufizojmë, të paktën staturën që ka një personalitet i tillë.

Te neni 18, tek atributet dhe kompetencat, ju thoni: “emëron dhe shkarkon zyrtarët zgjedhorë”. Nuk kam asnjë vërejtje për zyrtarët se si trajtohen, si bëhen dhe për çfarë përgatiten, por themi se atë tagër që i atribuohet atij që edhe emëron, se mirë shkarkon, sepse ka një motiv që e shkarkon, por mund t’i emërojë siç i do ai, sipas oreksit, aq më tepër, nëse nuk rregullojmë edhe pjesën e parë, ku themi që mund të mos jetë i kapur politikisht apo vjen drejtpërdrejt nga politika.

Në nenin 21, përsëri te kompetencat, KQZ-së i janë dhënë kompetencat të eksplorojë, të eksperimentojë dhe të vendosë përdorimin ose zgjedhjen e sistemeve të përdorimit të teknologjisë. Në qoftë se themi që këtë atribut duhet ta ketë KQZ-ja, ka ose jo dëshirë, mund të gjejë një arsye ose një arsye tjetër që mund ta ushtrojë këtë ose jo, kjo më duket disi evazive. Pra, i është lënë një kompetencë ndoshta më shumë sesa duhet. Në fakt, duhet

përcaktuar, siç ka qenë edhe më parë për rastet kur në mungesë të saktësisë së teknologjisë do të përdorej numërimi manual ose nuk do të përdorej teknologjia. Gjykoj se duhet parë.

Te pika 2, lidhur me sistemin e pajisjes për identifikimin, themi se duhet të synojë identifikimin biometrik të votuesve, votimin dhe, nëpërmjet pajisjeve elektronike, edhe numërimin nga pajisjet e votave të hedhura. Pse duhet thënë: “të synojë”? Ne mund ta themi direkt: “i mbetet detyrë që të realizojë këtë detyrim, identifikimin biometrik, votimin ose edhe numërimin e votave të hedhura”.

Në nenin 25 fjala “qartësohen” është përdorur disa herë. Ndoshta unë kam mungesën e njohjes gjuhësore që ta veçoj se çfarë është “qartësohen”, se unë e kam një kuptim për këtë fjalë. Ndërsa në gjetjet e mëposhtme më dilte herë pas here, ndoshta duhet të thuhet që të jenë të sqaruar personat ose të aftësuar, të përgatitur në mënyrë të tillë për ato detyra që u ngarkohen.

Te neni 25/2 bëhet fjalë për personat që do të jenë zyrtarë zgjedhorë të moshave dhe të kritereve të ndryshme. Ju thoni, midis të tjerave, në germën “ë” se i përjashtoni personat që kanë mbushur moshën zyrtare të pensionit. Me sa duket, të gjithë ne që po jetojmë këtë kohë, po i shtyjmë vitet e daljes në pension, por kjo jo sepse njerëzit janë të paafte të kryejnë detyra. Së paku, në këtë detyrë mund të jenë shumë më rigorozë në kryerjen e disa detyrave të tilla që ndoshta kërkojnë edhe përgjegjësi më shumë. Unë them që duhet parë, sepse ndoshta mund të jenë më të saktë edhe me disa të rinj që i plotësojnë kriteret.

Në nenin 30, përsëri te zyrtari i njësisë së administrimit zgjedhor, thuhet se ai nuk duhet të ketë marrëdhënie krushqie ose farefisnore deri në nivelin ose në brezin e katërt. Mirëpo shtrohet pyetja: a mund t’i gjejmë ata? Në qoftë se te një pikë më poshtë thuhet: “edhe me administratën të lidhur me shefin ose me drejtorin e tij”. Po kur i ndodh ministrit që është deputet, ku do t’i gjejmë ata persona, të cilët nuk kanë asnjë lidhje me të? Ndoshta duhet përdorur ndonjë modul, ose siç do ta gjykojnë ekspertët apo ju...

Te pika 3, në vijim të saj, te vetëdeklarimi thuhet sërish se personat do të duhet të vetëdeklarojnë se, për shembull, unë nuk kam asnjë lidhje me zotin Idajet Beqiraj. Ne na ka ndodhur që deputetët nuk kanë vetëdeklaruar saktë ose edhe gjyqtarët, madje ka edhe pasoja të tjera. Por ndoshta ai vetëdeklarim ka dhënë edhe pasoja te shkaku fundor i procesit. Atëherë, si do të veprohet? Si do të sillemi me të? Përsëri mbetet evazive.

Pika 3 flet sërish për personat që merren me njësinë e administrimit zgjedhor. Me sa vura re, që të mos ju ha edhe kohë, pashë disa ripërsëritje të të njëjtit modul te neni 37, ku

përsëriten disa elemente të neni 30; te neni 39 disa elemente të nenit 32 janë *mot a mot* (po e njëjta gjë), çka mund të thuhet se mund të vazhdojë nga i njëjti nen.

Te pika 3 përsëri në vijim themi se te vlerësimi, te qendrat e votimit, ju e shprehni kështu: bën vlerësimin e votave, numërimin e tyre për çdo subjekt zgjedhor dhe tabulimin e rezultatit. Ajo bën vlerësimin e votave, se cilat janë të vlefshme ose të pavlefshme, pastaj i ndan sipas subjekteve zgjedhore siç janë dhe në fund bëhet numërimi përkatës i secilit prej tyre, duke shkuar te rezultati përfundimtar (që bëhet tabulimi).

Për t'i rënë më shkurt, te pjesa e amendimeve ju citoni, midis të tjerave, te neni 42: “për moszbatim dhe shkelje me pasoja të rënda” dhe në fund thoni: “largimin e nëpunësit nga shërbimi civil”. A ishte e mjaftueshme kjo për të thënë që, pasi ka bërë edhe shkeljet e rënda, mjafton me një largim nga administrata?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te neni 42, tek amendimet, pjesa fundore.

Këto ishin tek ato që kemi thënë për ato gjëra që ne kemi sjellë si rekomandime.

Ju kërkohet ndjesë edhe në emër të disa miqve të tij, ndoshta do të mjaftonte vetëm një minutë, kam shtruar një pyetje edhe herën e parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fakti që të gjithë shtetasit kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen, do të thotë se edhe përpara këtij ligji ose, kur vjen radha e votimit, duhet të kenë po të njëjtin tagër ose të drejtë që ta ushtrojë secili prej nesh, pavarësisht se ka funksion ose jo.

Në kushte të tilla, shtroj pyetjen: a e kemi mundësinë të paraqitemi, jo të barabartë, por me kushte optimale përpara votuesve tanë? Unë gjykoj që, pa i hyrë me retorikë, kush shkon me helikopter, kush me Ferrari, kush zvarrë dhe nuk arrin dot që të gjejë një mundësi për të ndarë me ata zgjedhës që pretendon të marrë vota. Sepse i pari ka edhe mbështetje financiare, ka edhe ca lekë, merr edhe ca lekë, merr edhe një fond nga buxheti i shtetit dhe takohet; i dyti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam në fund, Damian.

I dyti nuk e ka fare këtë akses, ndoshta as të shkojë atje.

Pa dashur të zgjatem më tej, unë edhe herën e parë bëra një propozim që disa ishin dhe ca jo: a nuk do të ishte më mirë që zona zgjedhore, të cilat administrohen nga njësitë vendore, nga kryetarët e bashkive, në monitorim të drejtpërdrejtë nga KQZ-ja, të jetë ai shesh ose ajo sallë, të cilën e përdorin partitë njëra pas tjetrës në fasha kohore të ndryshme, pra të

shfrytëzojnë mikrofonin, altoparlantët, karriget dhe të jenë ata njerëz, të cilët kanë interes të dëgjojnë ato palë që mendojnë?

E fundit...

Damian Gjiknuri – Keni dalë jashtë teme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse të dyja pikat e fundit nuk kanë të bëjnë me çfarë po flasim.

Eduard Abazi – Po e mbyll me administrimin. Është ndryshuar praktika e numërimit të votave nga qendra e votimit. Me sa kemi dijeni, miqtë dhe kolegët janë këtu, për shkak se u justifikua që mungesa e kontrollit mbi të gjithë territorin e Shqipërisë u përqendrua në zona të tilla, mos ka ardhur koha për ta parë edhe këtë për të qenë më pranë atyre që votojnë, i numërojnë dhe nxjerrin një procesverbal, pra thjeshtojnë punën dhe shpenzimet?

Faleminderit!

Damian Gjiknuri – Në fakt, ju patët shumë komente dhe pyetje, që, natyrshëm, besoj se do t'i sillni edhe me shkrim. Unë nuk dua të ndalem te shumë prej vërejtjeve teknike, pasi jam i bindur që do të trajtohen seriozisht nga grupi i ekspertëve dhe nga komisioni, por dua të sqaroj dy gjëra, pasi nuk dua të përsëriten as si pyetje.

Në lidhje me kompetencën pse KQZ-së i lihet mundësia e eksplorimit, dua të jap shembullin e kodit të vitit 2012, ku, në mënyrë të detajuar (dhe unë kam qenë promotor i përfshirjes së çdo etape dhe çdo procesi sado teknik të shkruar në ligj), me qëllim që të kishim një kuadër ligjor të qartë në Kodin Zgjedhor për sa u përket proceseve teknologjike, kur erdhi momenti i aplikimit, vumë re se legjislatori nuk mund t'i parashikonte shumë prej elementeve teknike, sepse teknologjia avancon para njerëzve, aq më tepër ligjvënësve. Në përgjithësi, ligji ndjek teknologjinë, jo e kundërta. Kjo do të thotë se e vetmja mënyrë ku ne të jemi në *safe side*, pra në zonë të sigurt, është që eksplorimin e teknologjisë t'ia lëmë KQZ-së nëpërmjet implementimit me etapa dhe ligji të rregullojë parimet. Në përgjithësi, kjo është praktikë e njohur për sa i përket teknologjisë, të cilën e kam parë edhe në nivele të ndryshme qeveritare të administrimit publik. Pra, do të ishte gabim. Madje është një eksperiment tashmë i bërë që, kur e bëmë në vitin 2012, dështoi për disa elemente dhe ligji nuk i jepte përgjigje, automatikisht ato para shkuan dëm dhe eksperimenti nuk na lejoi që të aplikonim zgjedhje. E them këtë për parantezë, pasi e di që edhe të tjerë që na dëgjojnë mund ta kenë si pyetje.

Për sa u përket çështjeve të tjera, mendoj se ju ngritët disa çështje që grupi i ekspertëve dhe ne si komision do t'i shqyrtojmë. Nuk besoj se është vendi të jap përgjigje tani.

Për sa u përket dy pyetjeve të fundit, ato janë më shumë të karakterit të barazisë në garë apo financimit të fushatave zgjedhore. Këtu nuk e kemi atë temë. Ju e ngritët dhe herën e kaluar, e kuptoj shumë mirë, por kjo është një çështje që ne nuk e zgjidhim dot në këtë moment. Palët vërtet janë të barabarta përballë një gare, për sa i përket mundësisë për të konkurruar, por për sa i përket mjeteve, sepse është si puna e një kompanie dhe një grupimi politik, historinë nuk mund ta fshish. Unë jam i madh, nesër mund të jem i vogël, dikush që ka filluar i vogël nesër zmadhohet dhe, në fund të fundit, historia gjithmonë shpërblen fituesit dhe ai që fiton bëhet edhe i madh. Kush merr më shumë vota, merr më shumë financim. Unë them se ky është parim i drejtë dhe i gjithëpranuar, pasi nuk mundet që çdo individ që krijon një parti të ketë trajtim të barabartë me një parti, e cila ka shumë vite në tregun politik dhe, mbi të gjitha, ka vota.

Atëherë, pjesën tjetër besoj se e sollët me shkrim, nuk është momenti që t'i trajtojmë këtu.

Faleminderit për kontributin tuaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkitë t'i vënë në dispozicion pa shpërblim, por duhet të kuptoni një gjë: bashkitë gjithmonë për efekt të fushatave zgjedhore, për shembull, sallat e tyre apo kinematë e të tjera i vënë në dispozicion me shpërblim, pra me qira. Sheshet janë gjithmonë të lira për të organizuar aktivitetet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu është e drejtë kushtetuese, e drejta e tubimit. Nuk besoj se është penguar ndonjë subjekt politik për të marrë leje për të tubuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto janë shpenzime të fushatës, nuk jep gjë bashkia. Bashkia nuk të vë asgjë në dispozicion. Bashkia përcakton vendet ku do të reklamosh dhe policia të jep lejen. Kaq, çdo gjë tjetër është e partive politike. Nuk mbaj mend ndonjëherë që bashkia të ketë vënë gjë në dispozicion, për shembull, në fushatën time apo të kolegëve këtu. Kështu që ajo gjë është e sqaruar.

Faleminderit për kontributin tuaj!

Fjalën e ka Edmond Kasmi nga "G99".

Edmond Kasmi – Ne i kemi parë këto amendime në vija të përgjithshme nuk kemi pse të zgjatemi. Besoj se kolegët i kanë shprehur pak a shumë ato që kemi për të thënë.

Faleminderit!

Damian Gjikhuri – Faleminderit për vlerësimin!

A është ndonjë parti që unë nuk e kam në listën që ka ardhur?

Urdhëroni!

Kujtim Muça - Jam Kujtim Muça, kryetar i Partisë Demokratike për Integrim dhe Prosperitet.

Para se të filloj, kam një pyetje: kur do t'i heqim fjalët “sikur” dhe “do ta bëjmë”. Pse nuk e bëjmë votimin elektronik, KQZ-ja të jetë e pavarur dhe anëtarët e komisioneve? Ke sa të duash... Vetëm profesoreshë Vasilika duhet ta dijë sa juristë ka në Shqipëri, të cilët janë të papunë dhe keni mundësi që t'i sistemoni në komisione zgjedhore. Kur do t'i heqim këto? Pse nuk i bëjmë pas 30 vjetësh? Del Kosova me numërimin pas 24 orësh, kurse te ne duan 2 javë dhe mezi del numërimi. Si do ta bëjmë këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, kur do t'i heqim këto fjalë nga goja?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për tekstin nuk kam gjë dhe KQZ-ja automatikisht duhet të jetë e pavarur. Nëse do të bëhet përsëri me parti politike, unë votoj atë, unë nuk e votoj këtë, këtu përsëri siç ka qenë do të shkojë. Asnjë gjë nuk do të rregullohet. Draftin e kam lexuar në themel. Përsëri asnjë gjë nuk bëhet, nëse nuk heqim dorë nga KQZ-të me bërryla dhe me parti politike.

Faleminderit!

Damian Gjikhuri – Më duket se nuk e ke lexuar tekstin, por unë i vlerësoj pyetjet tuaja principale.

Urdhëroni, zoti Idajet!

Idajet Beqiri – Jam Idajet Beqiri, kryetar i Partisë Uniteti Kombëtar.

Me thënë të drejtën, i kam lexuar me vëmendje amendimet që i janë bërë administratës zgjedhore. Si jurist, dua të them se tek teknika e ndërtimit të të gjitha neneve shikoj një cilësi shumë të mirë. Me thënë të drejtën, jam shumë i kënaqur nga i gjithë ky draft që paraqitet dhe duket që mendimi i specializuar juridik është futur shumë mirë në ndërtimin e tyre, çka nuk e kemi vërejtur në amendimet që i janë bërë herë pas here Kodit Zgjedhor. Në tërësinë e tij nuk ka gjëra që nuk janë trajtuar, por janë shprehur ato shqetësime që, ne gjithmonë i kemi pasur, i kemi theksuar, por nuk kanë gjetur pasqyrime në Kodin Zgjedhor.

Pra, nuk janë bërë amendimet e duhura. Kështu që, në tërësinë e tij, jam plotësisht dakord dhe e vlerësoj punën e atyre që kanë punuar mbi këtë, pasi kanë bërë një punë të specializuar.

Kam shqetësimin që tha kolegu i partisë tjetër për amendimin që i keni bërë nenit 25/2 dhe keni shtuar nenin 25/3. Të gjitha kriteret qëndrojnë, por te pika 3, kur kërkohet arsimi i lartë, por më pas përvoja e punës 3 vjet, jam i bindur, duke pasur parasysh edhe moshën sa është, 3 vjet mua më duken pak. Nuk është problemi për të garë, ku njëri thotë 10, njëri thotë 5 apo 15, por të paktën minimumi mund të ishte 5 vjet përvojë pune, sepse, më thënë të drejtë, 3 vjet është pak, nuk është ajo përgjegjësi dhe përgjegjshmëri për një proces kaq të rëndësishëm.

Faleminderit!

Damian Gjikhuri – Faleminderit, zoti Beqiri!

Komentet tuaja ishin shumë racionale dhe të falënderoj për vlerësimin që i bëtë punës që kanë bërë ekspertët!

Atëherë, mos gaboj, nuk kemi më përfaqësues të partive politike, kështu që na jepni mundësinë që të zënë vendin përfaqësuesit e shoqërive civile. Duke ju falënderuar për kontributin tuaj do të mbetemi në kontakt në lidhje me të gjitha hapat e tjera që do të ndjekë komisioni.

Natën e mirë!

(Drejtimitin mbledhjes e merr zonja Hajdari.)

Rudina Hajdari – Atëherë në këtë pjesë të dytë të seancës dëgjimore kemi prezentë shoqërinë civile, kemi anëtarë të nderuar, që kanë ardhur për të dhënë rekomandimet e tyre në lidhje me draftin e dytë të ekspertëve të Komisionit për Reformën Zgjedhore për amendimet e administratës zgjedhore.

Të pranishëm kemi Institutin Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të zgjedhjeve, zotin Kristaq Kume, zotin Gogo. Nuk e di nëse është këtu. Po ashtu, kemi zotin Afrim Krasniqi, Instituti i Studimeve Politike. Uroj të kemi edhe anëtarë të tjerë siç janë Erion Tase nga Akademia e Studimeve Politike dhe nga Fondacioni Albania, zoti Tepelena dhe zonjën Gjikhondi. Po ashtu, nga Rrjeti në Barazi në Vendimmarrje, zonja Mirela Roshi, koordinatore kombëtare. Duke mos ju marr shumë kohë, ju ftoj t'i mbetemi temës dhe të dëgjojmë rekomandimet dhe opinionet tuaja në lidhje me draftin e dytë të prezantuar nga ekspertët për amendimet e administratës zgjedhore.

Fjala për zotin Kume.

Kristaq Kume – Faleminderit!

Para se të shpreh mendimet në lidhje me çështjet konkrete të trajtuara në këtë draft, vlerësoj se është e rëndësishme të vë në dukje se në draftin e paraqitur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më duhet të vë në dukje faktin se përveç trajtimit të çështjeve që lidhen me rekomandimet e dhëna nga misioni i vëzhguesve dhe ndërkombëtarëve të OSBE-ODIHR-it për administratën zgjedhore, është trajtuar në këtë draft edhe problemi i përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe ai i votimit të shtetasve që banojnë jashtë territorit të vendit, për pasojë mua më vjen ndërmend dhe është shumë e logjikshme të bëjë pyetjen. Domethënë, komisioni parlamentar për reformën në këtë fazë të punës së tij e ka zgjeruar fushën e veprimit, në kuptimin që objekt nuk janë vetëm gjetja e zgjidhjeve efektive dhe pasqyrimi në ligj i rekomandimit të misioneve të vëzhguesve ndërkombëtarë të OSBE-ODIHR-it? Në qoftë se është zgjeruar, atëherë pse komisioni nuk bën pjesë të punës së tij që në këtë fazë, edhe trajtimin e problemit të sistemit të zgjedhor? Nëse për këtë problem do të arrihet dakordësia në parim, ashtu siç është arritur për dy të tjerat, për përdorimin e teknologjisë dhe votimin e shtetasve që banojnë jashtë territorit të vendit, pyetja bëhet: a do ta konsiderojë si problem dhe do ta realizoj edhe këtë si detyrë të tij ky komision në këtë fazë të punës, pra problemin lidhur me sistemin? Kjo ishte gjëja e parë që doja të theksoja në këtë mundësi që më keni dhënë të shprehem përpara jush të nderuar anëtarë të komisionit.

Tani le të flasim konkretisht për draftin e paraqitur.

Së pari, drafti në të cilin trajtohet problemi për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për rikonfigurimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, propozon që në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të mos trajtohet vetëm problemi për parimin sipas të cilit duhet të plotësohet ai me anëtarë, por pjesë e këtij drafti është bërë edhe një problem tjetër, ai i konfigurimit strukturor të këtij institucioni. Në këtë rast, për mendimin tim, duhet të shtrohet pyetja: cilat janë arsyet? Pse kërkohet që ky institucion plotësisht kolegjal deri më sot të kthehet në një institucion me një kompetencë të theksuar dhe të rëndësishme monokratike? Në veprimtarinë e derisotme të këtij institucioni problemet që janë ndeshur nuk kanë qenë në asnjë rast pasojë e faktit se ai është ndërtuar si një institucion kolegjal. Në pjesën më të madhe të tyre këto probleme kanë rrjedhur nga efektet e parimit dhe të rregullave sipas të cilave janë zgjedhur anëtarët e këtij komisioni. Për rrjedhojë, përfshirja në këtë komision e një komponenti të rëndësishme monokratike është një gjetje që nuk i përgjigjet direkt problemit, hallit që kemi, për më tepër efektit të tij. Në rast se do të vendoset kështu, në administrimin e zgjedhjeve është vështirë që të parashikojmë se cilat do të jenë ato që mbeten

për t'u verifikuar. Kjo për sa i përket problemit në linja shumë të përgjithshme. Në qoftë se do të shikojmë më pas rregullat sipas të cilave është menduar që të ndërtohet edhe ky institucion i ristrukturuar, në draft parashikohet që komisioneri shtetëror i zgjedhjeve mund të jetë një shtetas që vjen nga radhët e ish-funksionarëve politikë, ish-nënpunësve të nivelit të lartë drejtues ose ish-drejtues të organizatave jofitimprurëse me veprimtari në fushën e zgjedhjeve dhe të drejtave të njeriut. Këtë të drejtë nuk e kanë shtetas që ushtrojnë detyrën në të tilla nivele, nëse ai është anëtar aktiv i një partie politike ose, në qoftë se ka interesa private të dukshme ose të njohura, plotësimi i të cilave varet nga qeverisja në nivel qendror dhe vendor, mandati i komisionerit parashikohet 7 vjet". Që kjo draftdispozitë të prodhojë efektin që synon, është e nevojshme që të parashikohet edhe lidhja, për mendimin tim, midis moshës që parashikohet në legjislacionin shqiptar për daljen në pension dhe këtij mandati 7-vjeçar, për sa kohë që pjesa më e madhe e tyre do të jenë "ish"-n. "Ish"-ët dihet që ose kanë dalë në pension, ose janë në prag të pensionit.

Kufizimet përjashtuese, të cilat kërkojnë që shtetasit të mos jenë në kushtet e ushtrimit të detyrës si funksionarë politikë ose të mos jenë aktivë të ndonjë partie politike, për mendimin tim janë evazive dhe lejojnë hapësira dhe mundësi për t'u interpretuar. Për të arritur në plotësimin e objektivit që synojë kufizimet e dhëna në pikat 4 dhe 5 të nenit 13, propozimi që unë bëj është: të zëvendësohen ato me këtë formulim: "Personi që kandidon ose që propozohet për komisioner nuk përfshihet në listën e kandidatëve që votohen, nëse në momentin e kandidimit është anëtarë i ndonjë partie politike ose kur komisioni kompetent i Kuvendit krijon bindjen se marrëdhëniet e tij me partinë politike e kanë ndërprerë për shkak të kandidimit ose propozimit për komisioner, ose nëse ka interesa private të dukshme ose të njohura, plotësimi i të cilave varet nga qeverisja në nivel qendror dhe vendor".

Në lidhje me Komisionin Rregullator, drafti parashikon që kandidati për anëtar të këtij komisioni të plotësojë kushtet dhe kriteret, së pari, për të qenë komisioner. Referuar këtyre kushteve, rezulton se kandidat të tillë mund të jenë edhe shtetas që janë anëtarë partie si dhe shtetas që kanë qenë anëtarë të komisioneve zgjedhore të propozuara nga partitë politike, në këtë mënyrë mundësia për të ricikluar komisioner të tillë, për mendimin tim, është shumë e madhe. Synimi që pritet të realizohet nga kjo dispozitë, për mua do të jetë i diskutueshëm, për sa kohë që kriteret për komisioner nuk janë përjashtuese këto që unë thashë. Komisioni i ankimimit dhe i sanksioneve parashikohet të formohet nga tre anëtarë nga shtetas që vijnë nga radhët e ish-gjyqtarëve, ish-anëtarëve të Komisionit Qendror dhe ish-nëpunësve të nivelit të lartë. Vlerësoj se përcaktimi i mësipërm nuk është plotësisht i

përputhur me objektin e punës së këtij komisioni. Kufizimi i vetëm te shtetasve që kanë qenë në detyrat e listuara më sipër është në vlerësimin tim një gjetje e sforcuar. Ky kufizim, nëse kjo dispozitë do të pranohet kështu, bën të nevojshme edhe për rastin e komisionerit shtetëror të trajtohet lidhja në këtë rast midis moshës dhe mandatit. Madje mandati i këtyre është parashikuar 9 vjet.

Referuar objektit të punës së këtij komisioni, një opsion tjetër, në bazë të cilit qëndron propozimi që kasti të formohet vetëm me specialistë me formim juridik, mund të formulohet si i tillë: “Kanë të drejtë të kandidojnë ose të propozohen për anëtarë të kastit shtetas shqiptarë që plotësojnë kushtet për të qenë komisionerë për një periudhë kohe jo më pak se 15 vjet, të ushtrojnë ose të kenë ushtruar detyrën e gjyqtarit, avokatit, noterit ose juristit në institucionet publike ose private.” Neni 15, pika 4, mund të hiqet, ashtu sikurse neni 15, pika 5, mund të shkruhet: “Personi që kandidon ose që propozohet për anëtar i kastit nuk përfshihet në listën e kandidatëve që votohen nga Kuvendi, nëse është anëtar i ndonjë partie politike, nëse ka qenë objekt rivlerësimi dhe nuk e ka kaluar me sukses procesin e votimit, ose nëse ka interesa të dukshme ose të njohura, plotësimi i të cilave varet nga qeverisja në nivel qendror dhe vendor”. Për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve alternativa, që unë propozoj, që ju mund ta trajtoni është që ky komision kolegjal të mbetet siç është, të ndërtohet si një organ kolegjal siç është aktualisht, dhe zgjedhja e anëtarëve të komisionit një ndër opsionet që mund të diskutohet, të jetë: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përbëhet nga 5 anëtarë, kryetari i komisionit të zgjidhet me short nga Këshilli i Lartë i Gjyqësorit, nga radha e gjyqtarëve që kanë përvojë pune jo më pak se 15 vjet, që kanë kaluar procesin e vetingut dhe që vetofrohen për këtë detyrë. Mandati i kryetarit të jetë 9 vjet i përsëritshëm. 4 anëtarë të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve të zgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë me 3/5 e votave, nga kandidatë shtesë që vetëofrohen për këtë detyrë. Në rast nuk arrihet zgjedhja me jo më pak se 3/5-at e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, atëherë administrata e Kuvendit hedh shortin midis të gjitha kandidaturave të paraqitura për votim, fituesi i njoftohet Kuvendit dhe shpallet i zgjedhur në seancën plenare të Kuvendit nga Kryetari i Kuvendit.

Kriteret për t’u pranuar kandidatura dhe procedura e përzgjedhjes së kandidatëve, me përjashtim të votimit fundor në Kuvend, të jenë ato që janë parashikuar në kodin aktual, në rastin e zgjedhjes së kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pra, ashtu siç parashikohet zgjedhja e tij, njësoj me këtë ndryshim dhe jo në fund fare ta votojë vetëm shumica. Mandati i anëtarit të komisionit qendror të zgjedhjeve të jetë 7 vjet dhe i përsëritshëm. Ky është propozimi im për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në lidhje me pjesën tjetër të administratës zgjedhore, drafti i paraqitur, në vlerësimin tim është një përpjekje për të ndryshuar në thelb parimin sipas të cilit është ndërtuar deri tani administrata zgjedhore. Objektivi që synohet të arrihet nëpërmjet këtij ndryshimi është ndërtimi i një administrate zgjedhore në të gjithë piramidën e saj me administratorë zgjedhorë që nuk propozohen nga partitë politike. Në vlerësimin tonë, zgjidhja që propozohet, referuar mjedisit aktual shqiptar është e vështirë që të arrijë të realizojë pritshmërinë që ajo synon. Në mbështetje të këtij vlerësimi, pra të mosarritjes së pritshmërive, mund të shërbejë ky arsyetim. Drafti parashikon që çdo shtetas me të drejtë vote, që është edhe nëpunës civil, zotëron automatikisht edhe cilësinë e komisionerit zgjedhor. Për më shumë, ndryshimet propozohet që të bëhen edhe në ligjin “Për nëpunësin civil”, në të cilin përcaktohet: “Nëpunësit civilë të të gjitha niveleve kanë detyrimin të shërbejnë si zyrtarë zgjedhorë”. Realitetet e sotme në vendin tonë në lidhje me administratën civile, e cila, pavarësisht nga legjislacioni në mbrojtje të saj, ka qenë përherë target i maxhorancave të radhës për largimin dhe emërimin sipas preferencave të tyre politike, tregojnë se mundësia për sjellje jopolitike nga nëpunësit civilë është e diskutueshme. Shtuar kësaj edhe fenomenin frekuent të presionit që ushtrohet nga maxhoranca e radhës mbi këta nëpunës gjatë proceseve zgjedhore, e bëjnë për mendimin tim shumë të diskutueshëm këtë zgjidhje dhe vështirësisht të pranueshme nga partitë politike që nuk i përkasin maxhorancës.

Për shtetasit me të drejtë vote, që nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil, në draft janë parashikuar kushte që duhet të plotësohen për t’u pranuar kërkesa e atyre që të përfshihen në programet e trajnimit dhe të certifikimit të KQZ-së.

Kushtet e parashikuara krijojnë mundësinë që komisionerët potencialë të jenë qytetarët me lidhje të forta politike, anëtarë të partive politike, përfshirë edhe ata që kanë kryer më parë detyrën e komisionerit si përfaqësues të partive politike.

Këta janë shtetasit që kanë shanse shumë të mëdha të aplikojnë për të marrë të tillë status. Qytetarët e paangazhuar politikisht, si rregull, duhet të jenë shumë më pak të motivuar për ta bërë këtë gjë.

Arsyet e mësipërme të shpien në përfundimin se administrata zgjedhore, megjithëse nuk do të formohet mbi bazën e propozimeve të partive politike, në veprimtarinë dhe sjelljen e saj ndaj ligjit do të jetë e ekspozuar në mënyre të ndjeshme nga presioni dhe lidhjet politike.

Ky është vlerësimi ynë.

Propozimi që ne bëjmë për administratën është:

Për ndërtimin e një administrate sipas rekomandimeve të misionit të vëzhguesve ndërkombëtar të OSBE/ODIHR-it, që në mënyrë të përsëritur kanë rekomanduar gjetjen dhe zbatimin e zgjidhjeve legislative, që bëjnë sa më mirë të mundur ndërtimin e një administrate zgjedhore të pavarur politikisht, të paanshme dhe me kapacitetet profesionale në nivelin e detyrës. Ndër zgjidhjet që ju, të nderuar kolegë, mund të diskutoni mund të jenë:

1. E drejta për të qenë komisioner zgjedhor nuk do të ketë asnjë lidhje me faktin se shtetasi ka statusin e nëpunësit civil. Zotërimi i këtij statusi nuk duhet të sjellë automatikisht që ky shtetas ka detyrimin për të qenë komisioner potencial. Heqja e këtij parashikimi bën të panevojshme edhe ndryshimet në ligjin “Për statusin e nëpunësit civil”.

2. E drejta për të qenë komisioner zgjedhor, përveç kushteve që duhet të plotësojnë shtetasit, të parashikuara në draft, duhet të kufizohet edhe me dy kërkesa të tjera:

- të paktën për një periudhë të fundit 5-vjercare të mos ketë qenë anëtar i një partie politike;

- në të paktën 4 proceset e fundit zgjedhore të mos ketë kryer detyrën e komisionerit ose numëruesit të propozuar nga partitë politike.

Komisionet e nivelit të dytë, të përbëra nga 4 anëtarë dhe dy sekretarë, kryetari dhe nënkryetari i komisionit, të zgjidhet me short nga KQZ-ja nga radhët e gjyqtarëve në gjykatat e nivelit të parë, me juridiksion zonat e administrimit zgjedhor përkatës. Në zgjedhjet me short për këto detyra KQZ-ja të përfshijë gjithashtu edhe avokatë dhe specialistë juristë që ushtrojnë aktivitetin në zonat përkatëse të administrimit zgjedhor, që ka jo më pak se 5 vjet përvojë pune, plotësojnë kushtet për të qenë komisionerë zgjedhor dhe që vetofrohen.

- Anëtarët e njësisve të administrimit zgjedhor dhe dy sekretarët zgjidhen me short nga KQZ-ja, nga shtetas që janë trajnuar, certifikuar dhe qartësuar për kryerjen e detyrës së administratorit zgjedhor dhe që janë votues në njësinë përkatëse zgjedhore. Për komisionerët e qendrave të votimit dhe grupeve të numërimit, ashtu siç propozuar në draft, pa asnjë ndryshim.

Lidhur me partitë politike dhe qasjen e tyre në procesin e administrimit zgjedhor, në draftin e paraqitur nuk i është kushtuar vëmendje fare problemit të qasjes së partive politike, subjekteve zgjedhore, në procesin e administrimit të zgjedhjeve.

Në kushtet kur, nga njëra anë, procesi zgjedhor parashikohet të administrohet nga një administratë që nuk ka lidhje me partitë politike dhe, nga ana tjetër, partitë janë garuese në këto procese, mendoj se është e domosdoshme që legjislacioni t’u krijojë këtyre subjekteve mundësi të plota aksesi për vëzhgim dhe operim.

Në legjislacion duhet të parashikohen detyrimet për transparencë të plotë në punën e administratës zgjedhore, në raport me partitë politike.

Ai duhet t'u krijojë hapësira efektive të plota këtyre partive për vëzhgim, monitorim dhe për të drejtë akses në informacion. Prezenca e përfaqësuesve të partive politike në të gjitha fazat e administrimit zgjedhor duhet të konceptohet dhe të realizohet ndryshe dhe jo ashtu siç parashikohet kjo e drejtë për vëzhguesit e pavarur vendorë.

Drafti i propozuar nuk i adreson të gjitha problemet dhe situatat që duhet të mbahen parasysh në rastin kur do të zbatohet votimi nga jashtë shtetit. Drafti u referohet vetëm atyre shtetasve që kanë vendbanim të përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kanë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit dhe kërkojnë nga KQZ-ja të pajisen me dokumentacionin për votimin nga jashtë.

Drafti nuk trajton rastet kur shtetasi ndodhet jashtë territorit të vendit për një nga arsyet e mëposhtme:

- punon në një mision diplomatik ose misione ndërkombëtare ku shteti ynë është partner;
- kryen studimet universitare ose pasuniversitare;
- ndodhet jashtë shtetit për arsye shëndetësore, për punësim të përkohshëm apo vizitë tek të afërmit.

Drafti nuk përcakton mënyrën dhe procedurën që duhet të zbatohet për votimin nga jashtë vendit. Janë disa lloje votimesh, si me postë, online, në qendrat e votimit që ngrihet andej, votim me prokurë e kështu me radhë.

Referimi i kësaj çështjeje për t'u trajtuar nga KQZ-ja për mendimin tim është një zgjidhje joefektive. Mendimi për mënyrën se si do të kryhet ky votim nga jashtë është një nga çështjet më të rëndësishme që kërkon vendimmarrje konsensuale nga forcat politike.

Në draft nuk trajtohet problemi i përfaqësimit dhe i fuqisë që duhet të ketë vota e shtetasve që banojnë jashtë territorit të vendit në konvertimin e saj në mandate. Për një vend si Shqipëria, ku numri i zgjedhësve që banojnë jashtë territorit të vendit është shumë i madh, gati 35-40% e të gjithë shtetasve me të drejtë vote, ky është një problem, që referuar Kodit të Praktikave të Mira për çështjet zgjedhore dhe dokumenteve të tjera ndërkombëtare është domosdoshmërisht i nevojshëm për t'u trajtuar dhe për t'i dhënë zgjidhje me ligj.

Sa më sipër, dokumenti i paraqitur, në vlerësimin tim, nuk ka formën dhe as përmbajtjen e një drafti përfundimtar. Në një masë të madhe ai është një dokument që mund

të konsiderohet si një dokument mbi të cilin është duke u punuar dhe ka nevojë për mendimin e ekspertëve.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Kume për prezantimin tuaj dhe për propozimin që ju bëtë në lidhje me çështjen e administratës zgjedhore!

Kemi disa pyetje që vijnë nga anëtarët e Komisionet të Reformës Zgjedhore, por do ta filloj unë e para, nëse mundem, pastaj do t'ia jap fjalën zotit Fino dhe zonjës Hysi.

Pyetja ime lidhet me administratën që ju përmendët, sa i përket këtyre tri strukturave, pra KQZ-ja përbëhet nga tri struktura: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator dhe Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve.

Ju thatë që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk duhet të zgjidhet nga parlamenti. Të zgjidhet nga parlamenti? Në nga problemet që kemi shtruar me ekspertët në takimin e fundit me anëtarët e Komisionit të Reformës Zgjedhore ishte pikërisht kjo. Në një situatë siç është kjo e sotmja, nëse ne do t'ia linim në dorë parlamentit shqiptar për të zgjedhur si komisionerin shtetëror të zgjedhjeve, ashtu edhe komisionerët rregullatorë dhe ato të KAS-it do të ishim në një situatë ku maxhoranca do ta kapte komplet KQZ-në.

Cili është sugjerimi juaj? A mendoni se ka një mënyrë që mund ta rregullojmë këtë?

Kristaq Kume – Së pari, për mua është shumë e rëndësishme që të zgjidhet problemi në parim: Do ta ndryshojmë strukturën e KQZ-së apo jo?

Nëse do ta ndryshojmë, pse? Pra, pse nga një institucion kolegjal kështu siç është do ta kthejmë në një komision monokratik. Pas kësaj, në vlerësimin tim, mënyra se si do të zgjidhet, qoftë komisioneri i madh, qoftë edhe të tjerët, nuk është e zgjidhur keq në draft, është e zgjidhur mirë, përveç atyre kufizimeve që ju thashë se çfarë duhet bërë më tej, që të bëhet realisht e mundshme dhe të mos bësh të mundshme që komisionerët që janë sot anëtarë të KQZ-së të jenë nesër po këta anëtarë të këtij komisioni. Ndaj unë kam propozuar, midis të tjerave, që në kushtet që duhet të plotësohen për të qenë anëtarë në administratën zgjedhore, nuk duhet të jesh anëtar partie, nuk duhet të kesh qenë komisioner dhe s'ka nevojë të vemi në Kinë për të gjetur kinezë që të vijnë këtu, por ka sa të duash shqiptarë që i plotësojnë këto kushte.

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Kume!

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino - Faleminderit!

Zoti Kume, duke respektuar eksperiencën tuaj në fushën e zgjedhjeve edhe si ish-kryetar i KQZ-së, më falni nëse nuk ju kam kuptuar mirë, por ne kemi një draft nga ekspertët. Ju, me sa kuptova unë, bëtë pyetjen se ku e keni marrë këtë.

Ju nuk u morët fare me draftin, por u morët me një propozim tuajin të ri për një komision të ri zgjedhor me 5 veta e të tjera.

Ne dëgjuam partitë politike që ishin të gjitha dakord dhe ishin të lumturuara që përfundimisht do të futnin partitë politike të drejtën për të qenë prezente, ndërkohë në diskutimin tuaj, kemi një strukturë ndryshe nga struktura aktuale ose me strukturën që keni punuar ju.

Në fakt unë nuk jam shumë dakord me konceptin tuaj “organ kolegjal” dhe “organ monokratik” se kjo strukturë nuk është monokratike. Kjo strukturë ka dy komisione, një rregullator dhe një të ankesave dhe sanksioneve që do të japin verdiktin që s’ka lidhje fare komisioneri qendror i zgjedhjeve.

Unë dua të bëj një pyetje direkte: Për këtë draft që është paraqitur në komision, a keni ndonjë mendim konkret? A ka risi pozitive në raport me KQZ-në që ka qenë gjithmonë në qendër të goditjeve nga partitë politike?

Kristaq Kume - Faleminderit!

Si duket mënyra e të folurit ka qenë e tillë që unë nuk kam arritur dot t’ua them kuptimin ose ju të kapnit atë që unë doja të thosha.

Së pari, unë nuk pyeta ku e keni gjetur, se unë di mirë që funksion edhe kështu dhe ka vende që e kanë monokratike. Madje, për kujtesë, i pari që e ka propozuar ndërtimin e KQZ-së sipas këtij rregulli është Ilirian Celibashi.

Unë nuk e shoh të keqen pse ndërtohet i tillë, por bëj pyetjen se pse kërkohet të ndryshohet. Kjo duhet të arsyetohet për sa kohë që ne kemi pasur deri sot një komision kolegjal me 7 veta, deri në 9 veta kemi arritur, një komision kushtetues me 7 veta (e ndryshuam dhe e bëmë me 9 veta). Pse? Dua të më mbushet mendja që bëhet për këtë arsye, ashtu sikurse, nëse palët bien dakord (palët jeni ju, partitë politike, këtu brenda dhe jashtë), që të kenë një strukturë të tillë ndryshe nga kjo, absolutisht, jam dakord, nuk ka asnjë problem. Nuk ka gjë fare me strukturën në kuptimin e asaj që funksionon më mirë apo më keq se sa kjo që kemi sot. Se si do të funksionojë, do ta shohim.

Problemi që unë kam ngritur nuk ka të bëjë me këtë gjë, por ka të bëjë me faktin se kush do të jetë, cilët njerëz do të jenë anëtarë të këtij institucioni, nga duhet të vijë ata?

Në vlerësimin tim, kështu siç është shkruar, që duhet të jetë vetëm komisioner për të qenë në KAS apo në Komisionin Rregullator (se aty thuhet që duhet të plotësojë kushtet e komisionerit dhe në kushtet e komisioneri nuk është përjashtues fakti nëse je anëtarë partie), ashtu sikurse nuk përjashtohet fakti (që për mua duhet përjashtuar) që personi ka qenë i angazhuar si komisioner i partive politike. Kjo do të thotë se nesër, unë, Kristaq Kume, komisioner i një niveli të caktuar, i dërguar nga një parti “a”, do të jem po prapë komisioner, sepse do të garoj, do të fitoj (në mos fitova me votë do të më bjerë gogla) dhe kush tha se nuk jam anëtar i asnjë partie, se unë deri sot e kam kryer këtë detyrë në emër dhe i dërguar në atë institucion nga partia.

A kemi mundësi të gjejmë njerëz që të vetofrohen pa këto dy cilësi? Unë mendoj se kemi mundësi dhe një institucion i ngritur në këtë mënyrë, duke përjashtuar këto dy gjëra që kanë lidhje me partitë, do ta bëjë edhe këtë strukturë të re shumë më të pranueshme nga partitë politike, se në fund fare, këto janë institucione të cilat do të administrojnë garën mes jush dhe ju duhet të bini dakord me njëri-tjetrin se kush do t’ua administrojë. Unë jam i sigurt 100% për këtë, se opozita jashtë parlamentit s’ka për ta pranuar ose do ta quaj faktin kryesor në një humbje të radhës, faktin se të gjithin e ka maxhoranca, sepse do të arsyetojnë kështu siç arsyetova unë tani (se do të shohin komisioner Kristaq Kume përsëri komisioner atje, pra e kishin deri dje dhe prapë do ta kenë në atë karrige).

Ky është merakun që kam unë. Hiquni mundësinë e kandidimit atyre që kanë ushtruar këtë detyrë në emër dhe të deleguar nga partitë politike!

Rudina Hajdari – Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Ju ndoqa me vëmendje zoti Kume dhe kam mbajtur disa shënime.

Kam një pyetje lidhur me strukturën e re të KQZ-së. Në fjalën tuaj të fundit thatë që nuk ka ndonjë problem për formën, por në fillim të prezantimit tuaj ju thatë që nuk besoj që problematikat me KQZ-në kanë ardhur për shkak të kolegjalitetit, por kanë ardhur për shkak të ndërhyrjes së partive politike.

Do të doja të qartësoni pozicionin tuaj. A jeni më shumë për formatin e KQZ-së që është sot apo të këtij organi, i cili nuk do të jetë me kohë të plotë dhe ka një ndarje të kompetencave dhe përgjegjësi?

E dyta, ju thatë që duhet të bëhet një draft që opozita jashtë parlamentit ta pranojë, sepse ky draft që është përgatitur nuk do të pranohet nga opozita. Për mua, e pëlqen apo jo maxhoranca në parlament apo opozita jashtë, besoj se ky nuk është thelbi i çështjes. Thelbi

duhet të jetë se a jemi ne në gjendje të pranojmë të bëjmë një administratë zgjedhore, e cila, një herë e përgjithmonë, do të krijojë besim te zgjedhësit që vota e tyre do të administrohet, do të numërohet sipas standardeve.

E them këtë sepse duke u kujdesur për faktin se çfarë do të thonë partitë politike, pavarësisht se vullneti në parlament do të duhet, ne harrojmë disa gjëra të tjera, pikërisht zgjedhësit.

Në fjalën tuaj ju thatë se mund të jenë gjyqtarë, mund të jenë avokatë. Në fakt, në bazë të Kushtetutës, gjyqtarit nuk i lejohej të ushtrojë asnjë detyrë tjetër, përveç të qenit gjyqtar. Pra, ky propozim juaji bie poshtë. Për avokatët i kemi thënë se mund të ushtrojnë vetëm mësimdhënien, madje me orar të reduktuar,

Në kuadrin kur Kushtetuta dhe ligjet e reformës në drejtësi, edhe ato që kanë qenë më parë, edhe këto tani, nuk e mundësojnë gjyqtarin dhe avokatin të jenë pjesë e trupës, qoftë në njësitë e administrimit zgjedhor, qoftë në ato të qendrave të votimit, grupet ku mund të për zgjidhen anëtarët janë nëpunësit civilë ose jo nëpunës civilë.

Pyetja që unë kam është se a keni ju ndonjë studim si përfaqësues të shoqërisë civile (jo vetëm ju, por edhe ndonjë organizatë tjetër), që me numrin total që duhet për njësitë e administrimit zgjedhor (që janë nga 6 anëtarë me këtë draft) dhe për qendrat e votimit, (pavarësisht nga 7, janë bërë me 3, por relativisht është numër i lartë), ne mund të përmbushim të tëra kriteret:

- që 5 vjetët e fundit të mos kenë qenë anëtarë partie, ndërkohë që ju e dini se deri tani, ne i kemi pasur anëtarë partie;

- që të mos kenë marrë pjesë në 4 zgjedhjet e fundit, që i bie gati 10 vjetët e fundit;

- që të mos kenë mbushur moshën e pensionit;

- që të mos jenë anëtarë partie aktualisht?

Pra, po të shikoni ka kaq shumë variabla, kaq shumë elemente, të cilat kur gërshetohen, unë, të paktën, me përvojën time modeste në politikë, mendoj se nuk do të ketë njerëz në Shqipëri. Nuk ka njerëz në Shqipëri, të paktën.

Në këtë kuadër do të doja të dija nëse këto sugjerime apo propozime që ju sollët, nisen thjesht nga dëshira e mirë për të mos pasur një, dy, tre grupe deri tani, apo keni një studim dhe këtë e vlerësoni? Se nuk duhet të biem në kolaps.

E treta, ju thatë që administrata zgjedhore nga nëpunësit civilë është shumë e diskutueshme, pasi është presioni i maxhorancës së radhës. Fakti që ne duam të shkojmë me këtë draft që kanë sjellë ekspertët, drejt një administrate, e cila do të jetë në databazen e

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Do të jetë e trajnuar, do të hidhet në short. Kemi vënë sanksione shumë të forta: humbje e së drejtës për të punuar, dënime penale, në Kodin penal, deri në tetë vjet burgim e të tjera e të tjera.

Mendoni se sot në vitin 2020 apo 2021, 2022, ka njerëz që do të sakrifikonin tërë karrierën e tyre, të futen në burg, për të mbështetur A-në, B-në apo C-në? Nuk e di, prandaj, po bëj pyetje.

Kam edhe një pyetje të fundit. Meqenëse një nga përfaqësuesit e mëparshëm të partive politike tha se zyrtarët zgjedhorë duhet të kenë jo më pak nga sa thuhet në draft, tre vjet eksperiencë pune, por pesë vjet.

Me gjithë këto kritere, a do të kemi numrin e mjaftueshëm të administratës zgjedhore?

Dhe e fundit, ky është një dokument pune, seancat dëgjimore nuk janë fiktive, por reale. Ne, si anëtarë të komisionit, nuk jemi shprehur akoma, ngaqë duam të dëgjojmë të gjithë grupet e interesit, sepse besojmë se do të dalë më e mira.

Unë mendoj se po nuk patëm besim, po për çdo draft që vjen në komision themi: jo nuk pranon Vasilika, jo nuk pranon opozita, jo është opozita brenda, atëherë më mirë të mos e ndryshojmë. Ngelëm duke bërë ndryshime, duke pasur gjithnjë probleme me KQZ-në, me administratën e të tjerë. Kemi nevojë për një frymë tjetër, besoj.

Faleminderit!

Kristaq Kume – Po e nis nga kjo e fundit.

Nëse unë do të kisha mendimin se ju jeni duke thënë fjalën e fundit, nuk do të vija fare këtu, por unë jam i bindur se e gjithë kjo është, e edhe unë së bashku me të, pjesë e procesit, që besojmë se në fund fare, do të sjellë diçka në mbështetje të punës që do të bëni ju. Ju jeni ata që jeni mandatar, që keni marrë nga Kuvendi detyrën për ta bërë këtë gjë. Ne vetëm ju mbështesim. Kjo do të thotë se unë nuk e quaj formale ardhjen këtu, sikundër nuk e quaj formale as ftesën që na keni bërë ju, për të ardhur këtu. Përkundrazi, e shohim si shumë të vlefshme. Prandaj, së bashku me kolegët e mi, i kam qëndruar me seriozitet kësaj pune.

Jam shumë larg situatës së 2005-ës apo të 2009-ës, kur anëtarë të këtij komisioni, pasi kemi bërë mbledhjen jashtë, kanë thënë: fol, fol, se këtu është vendosur se çfarë do të bëhet. Jam shumë larg asaj. Sipas meje, kanë ndryshuar shumë gjërat. Absolutisht po. Kësisoj, s'kishe pse ta bëje këtë vërejtjen e fundit. Sepse s'e kam ndërmend unë. Ose, nuk e di, mbase kam krijuar përshtypjen sikur mendoj se na keni thirrur formalisht këtu. Jo, absolutisht.

Le t'i marrim me radhë gjërat, për të cilat kërkuat që unë të sqaroja, lidhur me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Ajo që thashë në fillim, e që prapë po e përsëris, kishte të bënte me faktin se çfarë nuk është bërë mirë, në vlerësimin tim, ose që nuk është bërë deri atje ku është kërkuar dhe synohej të bëhej nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk ka qenë pasojë e faktit se ky komision ka qenë i ndërtuar kështu siç është sot, pra si një institucion kolegjal. Unë nuk e shoh të keqen ideja se kolegjaliteti, mënyra e të punuarit në mënyrë kolegjiale, ka prodhuar defekte në punën e vet. Duke qenë kështu, të marrësh vendimin për ta ndryshuar strukturën e tij, duhet të japësh patjetër argumente se përse do ta ndryshosh dhe se çfarë pret të bëjë tjetri më mirë nga ç'ë ka bërë ky, për shkak të këtij faktori: që është organ kolegjal.

Këtë kam thënë. Kjo është e shkruar. Unë do t'jua lë të shkruar këtu, pa asgjë tjetër pas. Pastaj, se mund të merret vendimi që të ndërtohet si i tillë apo si i atillë, ia dhashë edhe zotit Fino përgjigjen: po, s'ka asnjë gjë. Por, nëse qoftë se merret vendimi që rezultati të jetë efektiv në praktikë, nuk duhet pasur si kriter vlerësimi nëse duhet të jetë apo jo efektiv, ajo që ju keni kuptuar nga çfarë kam shprehur unë: që do të na e pëlqejë këtë gjë opozita jashtë parlamentit, apo jo? Po na e pëlqeu ajo, e bëjmë, po nuk na e pëlqeu s'e bëjmë.

Jo, nuk është kjo ajo çfarë thashë. Absolutisht jo. Thashë se ne jemi përpara një situatë, në të cilën nuk e dimë se çfarë do të realizojë një institucion i ndërtuar ndryshe, çfarë efektësh do të ketë vetëm ndryshimi i parimit në ndërtimin e tij, në miradministrimin e procesit, në krahasim me atë administrim që ka bërë ky institucion, i ndërtuar sipas këtij parimi.

Këtë thashë. Në lidhje me këtë, s'ka burrë nëne që mund të dalë e të thotë se çfarë mund të ndodhë. Është praktika ajo që e tregon se çfarë do të ndodhë.

E marrim dot riskun, që ta pranojmë se mund të ndodhë? Dakord, le të bëhen vlerësimet. Është në vlerësimin tuaj. Ne flasim, ju dëgjoni, mbani shënime, pastaj jeni ju që e vendosni. Po, patjetër.

Lidhur me këmbënguljen time, që statusi i nëpunësit civil të përkthehet në administrator zgjedhor, sepse duhet të bjerë gogla, që ta kryesh detyrën, nuk duhet të jetë kështu. Kjo nuk do të thotë se përjashtohen të gjithë nëpunësit civilë. Jo. Ligji i vendos të gjithë nëpunësit civilë në të njëjtën situatë, duke i bërë të barabartë me çdo qytetar tjetër që kërkon të vetëofrohet për marrjen e kësaj detyre. Do ta marrësh këtë detyrë? Hajde dhe nënshtrou rregullave. Në radhë të parë, a i plotëson kushtet? Po, duke qenë nëpunës civil, i plotëson kushtet.

Në qoftë se do të vendosim që të rishikohen ato dy kritere që përmenda unë: të mos kesh qenë administrator më përpara, si dhe të mos kesh qenë anëtar partie, atëherë bujrrëm,

nënshtroju trajnimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. S'ka pse të kemi një shërbim ekstra për këta, që i kemi komisionerë potencialë. Sepse, që janë goditur nga maxhoranca e radhës, kjo s'do as mend e as informacion, për sa kohë që të gjithë e dimë se në një pjesë të madhe jemi duke paguar dy administrata: një që është në punë dhe një që rri në shtëpi, por ka fituar gjyqin. Kështu që, në vlerësimin tim, duhet ta shohim këtë çështje ashtu siç është. T'i vendosim të gjithë qytetarët para mundësisë për të qenë komisionerë, pa pasur preferenca ndaj njërit, në krahasim me tjetrin, duke u trajtuar njësoj që të gjithë.

A ka shqiptarë që mund ta bëjnë këtë punë? Ka shumë shqiptarë. Nuk kam bërë ndonjë studim, por po qe se komisionerët e qendrave të votimit do të jenë me tre vetë, zgjidhje që e shoh si shumë të mirë, sepse s'ka pse të ketë më shumë. Kësisoj, i bie të kemi afro 14, 5 mijë apo 15 mijë qytetarë, të cilët do ta bëjnë këtë detyrë. Do të kemi edhe nja 700 të tjerë, që do të jenë në komisionet e nivelit të dytë. Gjithsej do të jenë rreth 16 mijë qytetarë.

Gjithsej janë 16 mijë qytetarë me të drejtë vote, që nuk janë anëtarë partie, që nuk kanë qenë në komisione më përpara. Ma merr mendja se persona të tillë mund të gjenden, sepse ka të tillë.

Megjithatë, i duhet rënë lapsit. Dakord jam për këtë.

Rudina Hajdari – Faleminderit shumë, zoti Kume!

Kristaq Kume – Sa i takon...

Rudina Hajdari – Le ta përmbledhim. Kemi edhe një pyetje tjetër, e pastaj duam një reagim nga ekspertët në lidhje me propozimet tuaja. Po ashtu, kemi edhe ekspertë të tjerë nga shoqëria civile.

Kristaq Kume – Lidhur me faktin se gjyqtarët e avokatët i ndalon ligji të marrin detyra të tjera, ligji është i shkruar, por edhe mund të rishkruhet. Qoftë edhe Kushtetuta, xhanëm. Pse, mos është e vështirë? Madje, e para gjë që thashë, është që të rishikojmë Kushtetutën, të ndryshojmë Kushtetutën në lidhje me sistemin zgjedhor. Për sa kohë që po shikoni gjëra që s'ju ka thënë OSBE/ODIHR-i që t'i trajtoni. As votën e emigrantëve s'jua ka kërkuar, as teknologjinë e informacionit s'jua ka kërkuar, por ama prapë i keni futur. Shikojeni edhe atë. Shumë mirë që i keni futur, por ama le ta çojmë të gjithën deri në fund.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Faleminderit, bashkëkryetare!

Në fakt, ky është paneli që unë kisha kënaqësi ta dëgjoja. Kam disa pyetje, të cilat mbase nuk janë vetëm për profesorin, por edhe për të gjithë panelin, pasi është një panel me njohuri specifike sa u takon çështjeve zgjedhore.

Pa u ngelur qejfi parafolësve të partive politike, unë këta dëshiroja të dëgjoja sot. Jo se kam ndonjë gjë kundër partive politike, sepse ata kanë gjithë të drejtën e tyre, dhe ky ka qenë edhe qëllimi i këtyre dëgjesave: të dëgjohet zëri i sa më shumë aktorëve dhe faktorëve politikë e jopolitikë.

Unë jam i interesuar për opinionet e më shumë se pesë-gjashtë zonjave dhe zotërinjve që janë aty, por ata që merren prej shumë vitesh me çështjet zgjedhore.

Shqetësimi i parë, të cilin e preku profesoresha, por mori përgjigje se nuk ka asnjë studim në lidhje me faktin e sa qytetarë shqiptarë janë të angazhuar në partitë politike. Sepse, koncepti i anëtarësimit në partitë politike, pak e nga pak po na kthehet në një koncept kriminal. Me këtë yrysh që kemi marrë, do ta fusim edhe në Kodin Penal, që atij që merret me partitë politike do t'i mohohen shumë të drejta. Nuk e di nëse ka ndonjë praktikë nga vendet e emancipuara e demokratike, që ka kaq ndalesa të njerëzve, të qytetarëve që angazhohen politikisht, që janë qytetarët më model të atyre republikave, mbretërive apo të çdo lloj forme organizimi që mund të kenë.

Unë po kërkoj një debat me këta, duke përmendur faktin se Partia Socialiste deklaroi 100 mijë deri në 120 mijë anëtarë, Partia Demokratike po kaq, LSI-ja diku te 50 mijë a 60 mijë anëtarë. Disa parti politike nga këto që janë me vite, kanë nga 10 mijë, 20 mijë anëtarë. Po të llogarisim numrin total të partive të tjera të mbetura, diku te 80, që sipas ligjit duhet të kenë minimumi 3 mijë anëtarë, mua më rezulton një numër mbi 750 mijë qytetarët shqiptarë, që janë anëtarë të partive politike. Ndërkohë, 770 mijë janë pensionistë, të cilët besoj se nuk i fusim dot në komision. Ja ku u bënë 1, 5 milionë. Po të shtojmë disa të tjerë, që nuk janë anëtarë partie, por kanë qenë komisionerë, sepse ka edhe raste të tilla, i bie që në 1, 7 milionë votues shqiptarë, numër ky në rastet më të mira, pra votues realë, ne duhet të kemi një kontigjent diku te rreth 100 mijë, mes të cilëve duhet të gjejmë afro 20 mijë. Janë 5800 qendra votimi, që shumëzuar për tre bëjnë 18 mijë e ca persona. Veç këtyre. do të mbash edhe një kontigjent rezervë.

Pra, ndër 100 mijë qytetarë të paangazhuar politikisht... Ju thoni pesë vitet e fundit, disa e shtrijnë në dhjetë vitet e fundit, katër zgjedhjet... Unë mendoj se nuk mund të bëjmë, dhe kërkoj ndihmën tuaj: a kemi kohë të bëjmë një studim? A kemi ndonjë studim? A keni ndonjë data baze ju të gjithë, pa ju drejtuar vetëm njërit, që të na orientoni edhe neve, sepse ky është qëllimi. Ne duam të marrim mendime, të rrahim mendime, kemi edhe ekspertët, të cilët i mbledhin të gjitha këto informacione, që në fund të mund të dalim me një vendim.

Ky është shqetësimi i parë, nga i cili doli edhe pyetja tjetër që ngrita: a kemi informacion se si e kanë vendet e emancipuara? Si i kanë zgjidhur rekrutimet e njerëzve? A i përjashtojnë personat që janë anëtarë të partive politike? Deri në ç' nivele bëhet përjashtimi? Sepse, jam dakord që i përjashtojnë në nivelet e larta, për t'i dhënë pavarësi sa më të madhe, por a mund të shkojmë në këto nivele? Se pastaj do të gjendemi ashtu siç u gjendëm me reformën zgjedhore, kur kandidaturat ishin të limituara në shumë vende, duke na prodhuar më pas gjëra të tjera. Madje, në shumë raste edhe kandidatura jo të mira. I diskutojmë jashtë tavolinave, por kur vjen puna në tavolina, i harrojmë.

Si do t'ia bëjmë? Mos është më mirë të kalojmë në gjetje mekanizmesh që nuk prodhohen nga partitë politike, nuk propozohen nga partitë politike, që japin llogari para ligjit e që trajnohen? Mos është më mirë të shkojmë drejt këtyre? Apo do ta bëjmë siç e kemi: përjashtojmë e përjashtojmë?

Nuk e kam me ju, sepse secili nga ju... më falni, jo secili nga ju, por një pjesë e mirë ka pasur edhe angazhim politik, një pjesë nga ju edhe në involvim të thelluar politik. Jeni shkëputur dhe keni zgjedhur një angazhim qytetar, civil. Pra, i kuptoni të dyja rastet shumë mirë.

E kam fjalën, që të mos gjendemi më pas në pozita, të cilat na sabotojnë zgjedhjet. Nuk mund të ecim pa studime në lidhje me këto.

Unë doja që në lidhje me këto shqetësime, kushdo, nuk është e thënë të jetë profesori, për të cilin kam respekt, si dhe për këto nga ju, që të na ndihmojë neve si anëtarë të komisionit, që të mbajmë shënime. Sepse nesër do të votojmë pikërisht opinionet më të mira, dhe ne nuk duam të bëjmë gafa, që të vijmë prapë pas një viti, për të thënë se e bëmë gabim te ky kodi, pasi na doli ndryshe në terren.

Ju faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Hyseni!

Mendoj se pyetjet ishin të përsëritura, kështu që është në dorën e zotit Kume, nëse dëshiron të reagojë në lidhje me pyetjet që sapo shtroi zoti Hyseni. Nëse më lejohet, do të doja të bëja një koment.

Mendoj se zoti Kume, mbase mund ta përmbledhë atë që thatë ju. Ju e përmendët pak më parë, se mbase nuk do të donit që një person si ju të jetë sërish në strukturën e re. Pra, ajo që kuptova unë, është se nuk duhet të kemi përsëritje dhe se nuk duhet të kemi njerëz, të cilët kanë qenë anëtarë apo funksionarë të një partie të caktuar, ndaj ne nuk mund të propozojmë një strukturë të re, duke kamuflluar një strukturë tjetër, të politizuar.

Pra, nëse do të ndryshojmë gjithë arkitekturën e administratës zgjedhore, atëherë duhet të bëjmë edhe ndryshimet përkatëse. Kështu, besoj se zoti Kume përdori një analogji, por ndoshta kishte vërejtjet e tij në lidhje me anëtarët që do të përbëjnë KQZ-në e re. Unë besoj se është kërkesë e drejtë nga ana e tij, në lidhje me këto anëtarë, që të mos jenë të përfshirë në partitë politike.

Ky është mendimi im personal. Gjithsesi, unë do të doja shumë të dëgjoja edhe reagimin e ekspertëve.

Zoti Rusmajli, fjala është për ju.

Ilir Rusmajli – Faleminderit, zonja bashkëkryetare!

Në fakt, jo për të reaguar, po më shumë për t'iu përgjigjur një kërkesë që na u bë nga zoti Kume, për të sqaruar një rrethanë, rrethanën se përse është zgjedhur kjo formë kompozimi e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në vend të formës aktuale të kompozimit, pra organizimi kolegjal i institucionit.

Unë mund të paraqes arsyetimin që ne kemi pasur. Nuk kam asnjë siguri se arsyetimi im mund të kënaqë personat e interesuar, por, së paku për hir të transparencës, është mirë që arsyetimin ta shprehim publikisht. Për ta bërë të qartë arsyetimin, mbase do të më duhet të kaloj pak në teorinë e zgjedhjeve, me dy fjali, nëse më lejoni. Në teorinë e zgjedhjeve, në atë që sot është standardi zgjedhor, i njohur dhe i pranuar nga ODIHR-i dhe Komisioni i Venecias, ka dy tipe administratash zgjedhore, ju e dini këtë. Është tipi i administratës zgjedhore politike, me përfaqësim politik, dhe tipi i administratës zgjedhore profesionale.

Shqipëria, deri më sot ka zgjedhur me vetëdije tipin e administratës zgjedhore politike. Ka eksploruar me vetëdije këtë tip administratë zgjedhore. Kur ka formatuar tipin e administratës zgjedhore politike, ka përdorur disa instrumente, të cilat i shërbenin këtij tipi të administratës zgjedhore politike. Shpesh ikën nga vëmendja, por një nga instrumentet thelbësore të këtij tipi, ka qenë formimi kolegjal i organit, kolegjaliteti si instrument i përfaqësimit politik. Ka qenë i projektuar si i tillë. Madje, ne kemi edhe një provë shumë elokuede të këtij fakti: kemi provën që dikur, kur përbërjen prej shtatë anëtarësh të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, politika shqiptare e ndjente ngusht për përmasat e veta, i vuri shpatullat dhe e zgjeroi, duke e bërë me nëntë anëtarë, ju e mbani mend këtë. Kolegjialitet politik i institucionit.

Tani, detyra që ne kishim përpara, ishte depolitizimi, do të thotë eksplorimi i shtegut tjetër, jo i shtegut politik. Në momentin që ne shkojmë drejt politizimit, duhet të heqim dorë

nga instrumentet e tipit tjetër. Duhet t'i rrëzojmë ato dhe duhet të përpiqemi të nxjerrim instrumente të reja, të cilat fuqizojnë tipin tjetër, që është neutral e profesional.

Nuk është se ne kemi dalë nga kërkesat dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR-it. Aspak. Por ne kemi prekur gurin e themelit të administratës zgjedhore. Të prekësh tipin, do të thotë të ringresh nga e para, se është urti i themelit.

Ne kemi zgjedhur jo një organ monokratik, por kemi zgjedhur një organ të përzier. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i përzier: është edhe monokratik, është edhe kolegjal.

Tani, pse kolegjaliteti i kësaj formule nuk është politik, ndërsa ai tjetri është politik? Sepse kolegjaliteti i kësaj formule i adresohet funksionit të trupës. Kudo ku ka nevojë për vendimmarrje kolegjinale, ka trupë kolegjinale. Kudo ku ka nevojë për vendimmarrje dhe drejtim individual, trupa është individuale.

Pra, logjika që ne kemi ndjekur në trajtimin e formës së institucionit, ka qenë profesionalizmi i tij, dhe jo përfaqësimi. Prandaj, kolegjaliteti këtu është profesional, ndërsa kolegjaliteti te komisioni ekzistues është politik.

Mund të ketë funksionuar deri më sot, por mund të ketë funksionuar edhe shumë keq deri më sot. Nëse e analizojmë me vëmendje raportin e ODIHR-it, jo vetëm te rekomandimet, por edhe te pjesa eksplikative e tij, mund të na dalë se në disa raste ka pasur funksionim shumë të keq të kolegjalitetit. Kështu ka ndodhur. ka ndodhur për arsye që mund të jenë edhe politike, por ka ndodhur kështu. Kolegjialiteti nuk ka përballuar dot ato detyra të cilat ka qenë i projektuar të përballojë.

Sido që ta trajtojmë, është e domosdoshme të shikohet forma aktuale, sepse bie themeli mbi të cilën ajo është ngritur, bie kompozimi politik i administratës zgjedhore.

Tani, më duket se ju, zonja bashkëkryetare, na kërkuat të bënim edhe një reagim në lidhje me faktin se si do të gjenden njerëzit.

Arsyetimi ynë, kur gjetëm atë kriter, kriterin e ish-ëve dhe kriteret e tjera që lidhen me të, sepse është një grup kriteresh që lidhen dhe janë të pandashëm nga njëri-tjetri, ka qenë shumë i thjeshtë. Domethënë, në rrethin e qytetarëve shqiptarë me të drejtë vote, cilat janë kategoritë që kanë eksperiencën dhe ekspertizën më të mirë të mundshme për ta bërë këtë detyrë? Janë këta. Fjala "ish" nuk ka lidhje me profesionin që ke pasur ose që ke ushtruar në jetën tënde. Ekspertizën ta jep kriteri tjetër, fjala "ish" ka lidhje vetëm me mungesën e konfliktit të interesit. Duhet të jesh "ish" që të mos jesh i kapshëm. Kjo ka qenë logjika që ne kemi përdorur këtë gjë. "Ish"-i njeriu që ka prerë marrëdhëniet me shtetin dhe qeverisjen, nuk ka interesa të vetat personale, të cilat mund t'i shfrytëzojë. Nga posti që ka marrë përsipër të

ushtrorë, ai njeri është i vlefshëm për ushtrimin e detyrës, por ata që janë në funksione nuk janë të vlefshëm, sepse ata mund ta konfundojnë interesin e tyre me interesin publik dhe pastaj të dëmtojnë qëllimin për të cilin janë emëruar. Në arsyetimin tonë kemi qenë pak pozitivist te formulimi, nuk kemi parë rrezikun e rezilzinjve që mund të na drejtojnë institucionet. Ne kemi parë mundësinë e hatashme të të mirëve për të ardhur këtu. Gjermanët thonë se, nëse do të pikturosh djallin në mure, djalli të del para, pra, nëse e shikojmë nga mundësia negative, së pari shprehim një mosbesim të pajustificueshëm drejt organit të emërtesës. I themi parlamentit sot haptazi se nuk je i aftë të zgjedhësh, nuk di e nuk do të zgjedhësh. Nuk është kështu. Parlamenti është më i afti për të zgjedhur në Shqipëri, sepse e ka provuar me qindra e qindra raste të emërimeve në organet e pavarura. Gjithmonë i emëron parlamenti, prandaj nuk duhet të kemi dyshim tek aftësia e parlamentit, nuk duhet të kemi dyshim as te aftësia e kritereve për të qëmtuar, sepse kriteret janë të matshme. Kërkohej jo një ekspertizë, por, sipas vlerësimit individual, kërkohej një ekspertizë që të jetë e provuar, që ka një sukses në jetën tënde të mëparshme profesionale, që të bën ty të aftë për të ushtruar profesionin. Kështu që nga kjo pikëpamje unë, kur shoh mënyrën si mund të kompozohet trupa, nuk shoh ata emra që i kam inat, që kanë qenë aty dhe që nuk më pëlqen t'i shoh më, unë shoh emra që nuk kanë qenë kurrë aty dhe do të ishit mirë që të ishin. Po ta them kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë, për shembull, shoh Kristaqin, shoh Gertën, shoh Afrimin dhe them a e plotëson ky formulim mundësinë që të jetë? Them se po, e plotëson. Atëherë formulimi është i mirë, sepse unë e di që ata që kanë dëshmuar që janë të paaftë për të ushtruar funksionet, parlamenti do t'i skartojë, sepse nuk ka interes të mbajë të paaftin, atë që ka prodhuar një produkt të keq në eksperiencën e vet profesionale. Kështu që nga kjo pikëpamje them se frika është gjithmonë aty, por nuk është e mirë të pikturojmë djallin në mur dhe pastaj ta mbajmë gjithmonë para vetes, sepse na bën keq të gjithëve.

Rudina Hajdari- Faleminderit, zoti Rusmajli!

Fjala për zotin Krasniqi.

Afrim Krasniqi – Faleminderit!

Në fakt, edhe në respekt të deputetit që bëri pyetje dhe mbeti pa përgjigje, unë po e nis nga përgjigjet.

Po, ekzistojnë studime, madje në tryezën e kaluar me OSBE-në i kemi cituar disa prej tyre. Çështja është se partitë kanë struktura fiktive, sidomos anëtarësi fiktive. Një nga gjërat që unë kam shënuar si kritikë është kriteri ku ne themi të verifikohet që të mos jetë anëtar partie. Cili është ai mekanizëm apo ajo zyrë shtetërore, apo ai instrument që verifikon nëse

individit është ose jo anëtar partie politike, kur e patëm këtë kufizim tek organet e drejtësisë dhe zgjedhëm një kryetar partie praktikisht? Pra, arriti puna deri atje. Kështu që Shqipëria nuk ka një regjistër të partive, çdo lloj referimi të burimi i anëtarësisë për mua është fiktiv, është më shumë për të qenë korrekt me OSBE-në se për të qenë funksional. A ka modele europiane? Po, ka sa të duash. Unë po marr si shembull modelin e kundërt. Cili është modeli evropian që ka militantë partiakë? Bjellorusia dhe dy-tri vende të tjera, por në vendet perëndimore nuk ka asnjë. Do të thotë që ekzistojnë formula pa fund për ta bërë.

Në lidhje me përqindjen, pse ndodh kjo gjë? Kjo ndodh sepse numri i anëtarëve me votues është rreth 18-20% e popullsisë së Shqipërisë janë anëtarë partie të deklaruar. Në vendet perëndimore shkon 3-5%, atje ka një numër shumë më të madh mekanizmash, të cilët e furnizojnë. Duke iu referuar pyetjes suaj për ta bërë më konkrete dhe të mos përsërisim gjërat, këtu përmenden 15 mijë punonjës që do të duhen. Po sa nëpunës civilë ka Shqipëria? Kaq ka deri, në 20 mijë me status. Kështu që ne po i marrim të gjithë dhe po i fusim aty. Ideja është që nuk arrijmë as me ata, edhe sikur ata të hyjnë të gjithë.

Kështu që unë mendoj se gjërat duhen parë më afatgjatë.

Në lidhje me çështjen se kush i prish zgjedhjet, them se zgjedhjet në Shqipëri i prishin partitë, nuk i prish mungesa e qytetarëve. Partitë kanë bërë si kanë dashur dhe kush ka vjedhur më shumë ka marrë postin më të lartë. Prandaj, këtu nuk është dënuar asnjë, ne kemi prova pa fund që marrin poste të larta, sa më shumë merr vota aq më shumë merr poste. Kështu që nuk funksionon kjo retorikë në rastin e Shqipërisë.

Në lidhje me problematikën konkrete, në lidhje me draftin, unë them se në momentin që hap debate, drafti është pozitiv. Unë futem te ata që formulën aktuale të KQZ-së e kanë quajtur një dështim të madh, sepse ka ca njerëz që partitë i gjejnë t'iu bëjnë punë dhe i bëjnë të pavarur për të thënë që janë praktikisht partiakë në vendimmarrjen e tyre. Çdo raport i OSBE-së dhe çdo raport i shoqërisë civile i ka kontestuar dhe ata vetë e kanë pranuar kontestimin. Kështu ka qenë një lloj procesi i tillë, që po ua lëmë partive të administrojnë zgjedhjet për të krijuar standarde për Shqipërinë, jo për një vend normal demokratik. Kështu që kjo formulë e KQZ-së është tërësisht e dështuar, sidomos përvojat fundit e dëshmuar këtë gjë, aq më tepër kjo praktika e bojkotit politik që vjen herë nga njëra palë herë nga tjetra, do të thotë që janë njerëz komisarë. Iu thotë partia të japin dorëheqjen, ata e japin.

Cila është zgjidhja afatgjatë? Ne sot në formulën e re na propozohen tri struktura me mandate të ndryshme, me imunitete të ndryshme, me përfitime të ndryshme, me CV të ndryshme, me prurje të ndryshme, por që janë vendimmarrje politike e parlamentit. Vërtet

parlamenti është institucion që zgjedh me siguri më të mirët, por në këndvështrimin tim nuk na ka rastisur të zgjedhë më të mirët, kështu që vendimmarrjet, sidomos nga institucione të ndryshme, nga burimet e parlamentit kanë qenë votë politike dhe janë votë politike. Derisa janë votë politike parlamenti do të zgjedhë individë ose me raporte politike, me konsensus të heshtur, ose përmes një nevojë emergjente politike, siç ka ndodhur në vitin 2017. Atëherë në këtë lloj rasti cila mund të ishte zgjidhja? Unë mendoj se do të ishte zgjidhja se nëse ne do të shkonim te një individ, pra një lloj strukture që mban përgjegjësi, e kemi më të lehtë për ta adresuar. Është më e rëndësishme për mua ta di që është filan individ përgjegjës dhe nëse shkel ligjin përgjigjet me burg, se ta lëmë kolektive, sepse pastaj askush nuk ka faj dhe të gjithë imunizohen. Ky draft si i tillë nuk i jep përgjigje kësaj, faktikisht krijon një strukturë kolektive. Unë nuk jam për nominale. Pastaj shkojmë te historia tjetër, marrim një rast, se ne në Shqipëri jetojmë, imagjinoni të na sëmuret ose të japë dorëheqje ose t'i ndodhë ndonjë gjë në momentet e fundit personit që e kemi caktuar për zgjedhje, çfarë do të ndodhë? Kështu që ne duhet të shikojmë në draft të gjitha variantet e mundshme edhe të emergjencës, edhe të tjera, sepse nuk mundet asnjëherë në kushtet e Shqipërisë, për shkak të presionit të madh politik dhe për shkak të mungesës së institucioneve funksionale, t'i varim të gjitha te vullneti i individëve ose te vullneti i një individi, siç propozohet në draft.

Cila do të ishte zgjedhja ideale për mua? Sipas mendimit tim për KQZ-në është e thjeshtë, duhen njerëz që nuk kanë lidhje me partitë politike dhe si të tillë promovohen vetëm misionet të cilat janë ose ligjore, ose me funksione në drejtësi, por që nuk janë direkt gjyqtarë ose prokurorë, ose akademikë. Pra, njerëz që nuk kanë lidhje dhe nuk kanë asnjë interes, madje për mua nuk duhet të jetë organ i përhershëm, vetëm nëse do të jetë nominal. Është absurde që ne paguajmë anëtarë katër vjet kur zgjedhje kemi 4 muaj. Në aspektin afatgjatë mund të ishte funksionale nëse ne operojmë me këtë formulë për të plotësuar dhe ndoshta përmirësuar shumë aspekte, të administratës publike për nivelet e dyta dhe të treta. Pyetja është pse na duhen 7 anëtarë komisionesh? Ka vende që e bëjnë me 2, ose edhe me 1. A na duhen kaq qendra votimi? A na duhen kaq komisione zgjedhore? A na duhen kaq struktura? Ne paguajmë një ushtri të madhe për një proces që është një lojë, e cila, kur mbaron, të gjithë e dimë se do të kontestohet. Kështu që edhe kjo kërkon një debat. Nëse ekspertët do të thoshin sot se kanë propozuar këtë draft për pas 10 vjetësh, për mua është pozitive, do të thotë se pas 10-15 vjetësh, kur Shqipëria të jetë e moderuar si shtet, të ketë krijuar pjekurinë dhe të kenë ndryshuar brezat e administratës publike, mund të jetë e besuar, por në kushtet aktuale të administratës publike t'i japësh fatin e zgjedhjeve, praktikisht kemi krijuar thjesht

asgjënë, argumentin e ri të rrëzimit të zgjedhjeve. Raporti i fundit është shumë kritik ndaj sjelljes së administratës kur nuk pati zgjedhje konkurruese, dhe imagjinoni pastaj kur nuk ka zgjedhje. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në të kaluarën, madje ne po e vendosim administratën publike në një lloj pozite që nuk është komode. Një nga kritikrat që unë do të bëja këtu është se unë jam qytetar, kam të drejtën kushtetuese, pse duhet të më detyrojë njeri për të hyrë në një funksion që unë nuk dua ta bëj, siç i detyrojnë praktikisht nëse u bie shorti individëve të caktuar. Nëse do të kombinohej kjo me një sërë elementesh, atëherë po, mund të shkohej te një zgjidhje më afatgjatë.

Në lidhje me elementet e tjera, përshtypja ime, qofsha i gabuar, por këto funksione, mënyra si janë ndërtuar këtu bashkë me kriteret, tregon se mungon vetëm emri i individit. Pra, më duket se kriteret janë bërë për individë të caktuar. Këtu janë elemente që individit të ketë edhe eksperiencë profesionale në hartim, shqyrtim, miratimin e akteve ligjore, pra gati kemi shkuar te një listë prej tre katër vetash.

Mësimi që ne morëm nga reforma në drejtësi, në disa klauzola ku ne kufizuam shumë kriteret dhe pastaj nuk gjendeshin kandidatet, po përsëritet edhe këtu, pastaj do të shkojmë te po të njëjtit individë, sepse veç ata i plotësojnë kriteret.

Në lidhje me zyrtarët politikë, pse duan zyrtarët politikë të marrin pjesë në zgjedhje? Për mua është kufizim, duhet të jetë shumë më tepër se kufizimi që është vendosur dhe “ish” –zyrtarë funksionarë politikë. Për mendimin tim duhet të jetë 10 vjet. Ç’punë kanë politikanët që të marrin pjesë në administrimin zgjedhor? Politikanët janë njerëz publikë që kanë një jetë tjetër dhe përvojë tjetër dhe nuk kanë nevojë të kthehen, kushdo qoftë, të kthehet në nivelet e administrimit zgjedhor. Personalisht i shoh të larguar dhe kështu duhet të jetë.

Në lidhje me shprehjen “komisioni krijon bindjen” do të thotë se çdo njeriu në Shqipëri mund t’i vendosësh kryq dhe e eliminon nga lista, sepse thjesht ka krijuar individ bindjen që ky individ nuk i plotëson këto lloj kriteresh.

Në lidhje me strukturën, po vazhdoj me gjëra që nuk janë thënë nga kolegët, eksperimentimi i fundit na kushtoi 4 milionë euro, dhe imagjinoni që të bëjmë përsëri eksperimente. Unë do të dëshiroja që gjithë struktura që përmendet këtu dhe pjesa teknologjike t’i lihet kompetencë KQZ-së të nxjerrë akte, ta rregullojë, të mos e bëjë me ligj. Ata kanë përgjegjësinë si çdo institucion tjetër shtetëror që, kur bën një praktikë, mban edhe përgjegjësi për praktikën, nëse bëjnë të gabuar është përgjegjësi e tyre. Në zgjedhjet e fundit për shkak se u mor një program nga një vend tjetër mezi nxirreshin të dhënat për arsye se

personi nuk pranonte, kompania nuk pranonte t'i jepte lejen ose aksesin për të plotësuar. Mësime të tilla duhet të jenë të reflektuara në një aspekt më afatgjatë.

Po ashtu, në lidhje me votën e emigrantëve, ka disa elemente që unë personalisht e pashë në një kapitull më shumë të futet për t'u bërë, por jo se zgjidh gjë, sepse ne dallojmë shumë nga vendet e tjera. Asnjë vend në rajon nuk ka numër emigrantësh aq të madh në moshë madhore në raport me popullsinë votuese në vend, kështu që, nëse Maqedonia e Veriut, Kroacia kanë pasur një numër të kufizuar dhe kanë rezervuar vende, edhe Maqedonia e Veriut i hoqi ,sepse nuk rezultoi e suksesshme si strukturë. Nëse ne i themi mbi 1 milion shqiptareve që janë jashtë shteti, të vijnë e të votojnë, si do ta garantojmë votën e tyre? Si do të përgjigjen shkeljet ligjore në rastin e tyre. Përfshirja dhe koncepti i qarkut Tiranë për mua nuk është në rregull, sepse ka formula të tjera shumë të mira. Kështu që e pashë si një çështje që më shumë e hap debatin se e mbyll dhe nuk mendoj se duhet trajtuar në këtë moment për sa kohë që nuk ka një regjistër dhe nuk ka një projekt konkret për të shkuar te vota e emigrantëve.

Pastaj ka detaje të tjera teknike, si për shembull, kriteri që duhet të ketë mbaruar *bachelor*, diku thuhet në vit të tretë diku *bachelor*. Duhet të jeni në dijeni që në Shqipëri me ligjin e arsimit të lartë ka filluar një strukturë e re arsimore, përfshirë edhe fakultetin juridik, ku nuk ka më *bachelor*, ka studime të integruara. Kështu që ka rënë fjala *bachelor*. Nuk mund t'i kemi në ligj disa gjëra të tilla që tashmë kanë rënë dhe nuk ekzistojnë si kritere.

I vetmi merak që kam dhe që dalloj nga kolegu Kume, është se ne njohim pa fund komisionerët që kanë abuzuar me votën. Ne duhet të gjejmë një mekanizëm që ata individë të mos jenë pjesë e proceseve të reja, madje edhe individë, të cilët janë paditur nga strukturat zgjedhore në prokurori, pavarësisht se prokuroria nuk ka marrë asnjë masë ndaj tyre, duhet të kemi një kompromis që të mos i lejojmë të marrin pjesë. Kemi rastin e fundit të vitit 2015, KQZ-ja bëri një padi për një numër individësh, por prokuroria e mbylli, sepse tha se nuk kanë devijuar tërësisht procesin zgjedhor. Realisht u pranuar që ata e kanë bërë se e kanë bërë para kamerave. Këta individë nuk duhet të jenë më pjesë e strukturës dhe për këta individë duhet gjetur një mekanizëm për t'i larguar. Ne njohim komisionerë që nuk është bërë asgjë dhe kanë vite që kanë treguar një lloj integriteti se ka ndryshuar Shqipëria. Kështu që nuk duhet të bëjmë apriori përjashtimin, por duhet gjetur një mekanizëm që largon individët e kontestuar dhe një mekanizëm filtrimi, i cili nuk duhet të jetë në dorë të partive politike, por duhet të jetë institucional që i verifikon ata.

Edhe kriteret që ishin futur këtu, ish- gjyqtarë dhe ish-prokurorë, unë pyes do të jenë këta që po largohen nga sistemi apo të tjerë? Nuk ka më gjyqtarë dhe prokurorë, ata ose janë në pension , sose janë larguar nga sistemi. Po këta që janë larguar nga sistemi si mund t'i fusim ne në sistemin e së ardhmes?

Po ashtu në lidhje me kategoritë e punonjësve civile, të cilët ishin ish- punonjës të shërbimit civil. Ka individë, të cilët janë larguar për arsye politike, por edhe e kanë të vështirë ta provojnë se janë larguar në mënyrë të padrejtë dhe ta fitojnë gjyqin. Proceset zgjasin shumë, ne i përjashtojmë praktikisht deri sa të shpallim individët tërësisht të çliruar nga barra ligjore. Ky është një luks i madh për Shqipërinë, sepse proceset në Shqipëri, sidomos në Gjykatat Administrative zgjasin.

Në të gjitha strukturat përmendet referimi “zgjedhjet lokale”, “zgjedhjet parlamentare”. Në Shqipëri ka ardhur koha, siç e thonë edhe shumë aktorë politikë, të kemi referendume, kështu që duhet që e njëjta administratë të vlejë edhe në rastet e referendumeve, sepse nuk do të bëjmë ligj të ri vetëm për strukturën e referendumeve.

Po ashtu, në lidhje me shortin, unë personalisht jam kundër shortit. Shorti nuk ka qenë ndonjëherë i suksesshëm, pavarësisht se ne kemi praktikuar në disa raste, nuk merren këto vendime që merren, po themi siç është rasti Kejdi, ose Pir, ku janë deri diku në nivel krejt tjetër përfaqësimi, por shorti në Shqipëri nuk ka funksionuar. Shorti pastaj jep një legjitimitet, i cili është i rastësishëm dhe automatikisht sjell kontestime, sapo të mbarojë. Kështu që më mirë t'iu besojmë letrave dhe dokumenteve të një sistemi transparent, për verifikimin e individëve sesa të shkojmë dhe t'ua lëmë rastësinë goglave dhe individëve, numrave që prodhojnë këta individë.

Pak a shumë këto janë gjërat. Këtu ka një numër të madh gjërash, nuk dua t'i përsëris, por këto janë gjërat kryesore. Problemi është që për të bërë një debat të tillë , për të reformuar sistemin e administrimit zgjedhor unë nuk njoh njeri që nuk e kupton, që ka ardhur koha që partitë nuk duhet të kenë më rol, por ama nuk besoj se ka njerëz që besojnë se vendimmarrjet politike dhe në parlament mund të prodhojnë këtë gjë.

Së dyti, nuk besoj se në kushtet aktuale të Shqipërisë do të arrihet një kompromis i gjerë politik për të shkuar te një depolitizim i administratës zgjedhore, kështu që unë mendoj se nëse ne operojmë duke respektuar axhendën e komisionit, nëse ne operojmë me dy faza, rekomandimet e ODIHR-it dhe OSBE-së, le t'iu japim përgjigje atyre dhe të gjitha këto propozimet e tjera, të cilat janë pjesë e një pakete më të madhe ndryshimesh, le të jenë opsione. Të them të drejtën do të dëshiroja që kur të thirremi në komision të japim mendime

për punët e komisionit dhe për gjëra që ka komisioni, sepse ekspertët janë njerëz të nderuar, me shumë kontribut, por në fund fare janë mendime personale dhe deri diku edhe ne nuk jemi aq pa punë sa të komentojmë gjithçka.

Rudina Hajdari - Faleminderit, zoti Krasniqi!

Kemi disa pyetje nga anëtarët e komisionit.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Fino, kemi disa pyetje nga anëtarët e komisionit, zonja Gjylameti, gjithashtu edhe unë kemi një pyetje.

Në fakt, shorti është menduar nga ekspertët si një mekanizëm zhblllokues. A keni ndonjë mekanizëm tjetër nëse nuk jemi dakord me zgjedhjen e komisionerëve? Çfarë do të propozonit ju?

Faleminderit!

Afrim Krasniqi - Nëse unë respektoj logjikën e momentit, në momentin që këtu bëhet e gjithë struktura dhe njerëzit kalojnë testimin, pranohen dhe certifikohen, s'ka nevojë fare për short, gjërat janë të zgjidhura, plotësohet automatikisht dhe zgjidhen si njerëzit, të cilët janë anëtarë, si anëtarët zëvendësues... Për KQZ-në, për të dyja palët me persona zëvendësues, të gatshëm të zëvendësojnë, siç operuam me reformën në drejtësi, zgjidhet një anëtar dhe një zëvendësues.

Rudina Hajdari – Zoti Krasniqi, besoj se e kishit fjalën për komisionerët, si ata rregullatorë dhe të kastit, që pritet të zgjidhen nga 2/3 e parlamentit. Nëse nuk gjendet kjo dakordësi, në mënyrë zhblllokuese është parashikuar të ketë një short.

A keni një propozim tjetër në lidhje me mekanizmin zhblllokues?

Afrim Krasniqi – Së pari, propozimi im ishte që të mos kalojë në parlament, sepse nuk besoj se në kushtet që ka Shqipëria, parlamenti ka forcën e duhur për të zgjedhur individë, të cilët nuk kontestohen. Strukturat më të besueshme në kushtet aktuale të Shqipërisë, nëse flasim për zgjedhje, janë strukturat e reja, të gjykatave të KLP-së dhe KLGJ-së. Mund të gjenden struktura të ndryshme alternative për ta çuar, pse duhet të investohet parlamenti se cili do të jetë anëtari...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Parlamenti është institucion kushtetues.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk kam besim që parlamenti zgjedh individë të pavarur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino, unë në respektin tuaj jam këtu sot.

Në kushtet aktuale të Shqipërisë, çdo produkt i ardhur nga parlamenti, sidomos kur bëhet fjalë për zgjedhje, është i kontestueshëm.

Rudina Hajdari – Ju lutem, respektoni komisionin dhe kërkoni fjalën, në mënyrë që të respektojmë radhën e fjalës së zonjës Gjylameti!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti Fino, që më latë radhën për të folur!

Zoti Krasniqi, për shkak të eksperiencës suaj të gjatë, po ashtu edhe të pjesëtarëve të tjerë të panelit, do të kisha dashur të dëgjoja një qasje komplet tjetër sot. U bënë gati tashmë 30 vjet që gjatë gjithë kohës ne përgjithësojmë, akuzojmë dhe kemi kontribuar të gjithë bashkë, qoftë klasa politike pozitive-opozitive, qoftë organizat jofitimprurëse, qoftë media apo çfarëdolloj institucioni tjetër që të krijojmë një mosbesim ndaj çfarëdolloj institucioni apo grupi pune.

Besoj se ka ardhur momenti të ndryshojmë qasje. Nëse drafti që keni para propozon ndryshime konkrete si në pjesën e adresimit të rekomandimeve të OSBE-ODHIR-it, po ashtu edhe të kërkesave që kemi ne si anëtarë të parlamentit për ndryshimet përkatëse apo si pjesëtarë të partive politike, po ashtu edhe në përgjigje të problematikave që keni ngritur për t'i adresuar ndër vite, do të doja të kishim një qasje ndryshe. Shpresoj që ju t'i keni sjellë ndryshe propozimet me shkrim, por nga fjala që dëgjoja pashë se kishte sërish qasjen që kemi pasur, pra një kontribut për të vazhduar ende me frymën e mosbesimit. Çfarëdolloj ligji të bëhet në Shqipëri, sido që të implementohet, nëse ne vazhdojmë të kontribuojmë për të mos pasur besim, asgjë nuk ka për të ndryshuar. Nuk është gjithmonë faji i një ligji, por është ajo çfarë ne kontribuojmë të gjithë bashkë.

Diskutuat që nga pjesa e nivelit më të lartë, pra të komisionerit, të kastit, të rregullatorit duke zbritur në të gjitha nivelet dhe dëgjoja se kishit kritika për çdo gjë. Ndërkohë shpresoj që me shkrim të keni sjellë edhe propozime konkrete si mund të ndryshohen ato.

Dy ekspertët e komisionit apo edhe ekspertë të tjerë që na janë bashkëngjitur, nuk vijnë si ekspertë të pavarur, në kuptimin dy njerëz që vijnë dhe sjellin një punë të tyre, por adresojnë ato çfarë kemi pasur si rekomandime apo kërkesa. Pa dashur të mbroj punën e tyre, por duke pasur dëshirën të arrijmë së bashku në një gjë konkrete me rezultate ndryshimi dhe që u jep mundësinë të gjithë votuesve që të fillojë fryma e besimit ndaj institucioneve, do të kisha dashur të shoh propozime konkrete sot. Për ne është shumë e vyer qoftë eksperiencia

juaj, qoftë mendimi që keni, sepse, në fund, të gjithë së bashku, keni vite që merreni me këtë fushë.

Do të doja të shtjelloni konkretisht qasjen tuaj te pjesa e komisionerit, për kriteret e përzgjedhjes. Dëgjova që kishit kritika ndaj kriterëve të përcaktuara, se thatë: “Është sikur të ngushtojmë akuariumin ku përzgjidhet”.

Së pari, pse e mendoni këtë, që edhe ne, anëtarët e komisionit të jemi të qartë?

Së dyti, te kriteret e përzgjedhjes, çfarë mendoni se duhet ndryshuar për të qenë më mirë?

Së treti, thatë që kur nuk është nominative dhe është kolegjiale, nuk ka përgjegjësi direkte. E keni vetëm për komisionerin, te kasti, te rregullatori apo në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore. Pyetja e parë që kam.

E dyta, thatë se 6 anëtarët e ZAZ-ve janë një numër shumë i madh. Gjithmonë kemi pasur kritika, të gjitha palët, por mbi të gjitha qytetarët që presin rezultatin zgjedhor. ZAZ-ja ka edhe orët e pushimit, se njerëzit nuk mund të punojnë 24 orë, dhe, nëse nuk do të ishin më pak anëtarë, do të vonohej dalja e rezultatit. Kur thuhet janë 4 anëtarë, 2 sekretarë dhe 2 grupe që punojnë me dy turne 2 plus 1, pse mendoni se është i tepërt si numër?

Pika e tretë, thatë se do të ishte mirë që komisioni i qendrës së votimit të jetë edhe me një anëtar. A mendoni se zgjidhet duke pasur vetëm një anëtar dhe ku referoheni për këtë? A ka një praktikë në ndonjë vend të zhvilluar që të ketë një komision të qendrës së votimit me një anëtar? Kjo është ajo që kuptova unë, por unë mund të jem edhe e gabuar.

Diskutuat në krye të herës pjesën e anëtarësisë, thatë si mund ta vërtetojmë pasi në Shqipëri llogaritet një përqindje shumë e lartë votuesish të anëtarëve të partisë. Meqenëse një nga kriteret është që të mos ketë qenë anëtar partie, thatë se do të duhet të ishte ndryshe. Si e mendoni, si do të duhet ta zgjidhim ndryshe? A ka një praktikë të vendeve të tjera që të dorëzohet edhe lista e anëtarësisë? Këtë mendoni apo keni qasje dhe propozim tjetër?

Diskutuat që parlamenti nuk voton i lirë apo është i varur në votimin që bën. Nëse nuk duhet ta zgjedhë parlamenti komisionerin apo dy anëtarët e tjerë të trupës, qoftë të kastit apo të rregullatorit, kush duhet t'i zgjedhë sipas jush? Në dijeninë time, jemi republikë parlamentare, nëse jo, çfarë propozimi konkret keni? Si mendoni, do të ndikojë kjo që të rritet besimi i qytetarëve ndaj trupës së administrimit zgjedhor dhe a mjafton vetëm kjo?

Më pas diskutuat pjesën tjetër për çështjet që jeni mosbesues, ka pasur edhe raste hetimi, edhe pjesë të gjyqimit, por ndërkohë nuk ka ndryshuar. Çfarë propozoni ju

konkretisht të ndryshojë në administrimin zgjedhor, në trupën zgjedhore për të ndryshuar ekzaktësisht atë që pasqyrohet? Pra, një mosbesim total ndaj trupës zgjedhore.

Faleminderit!

Afrim Krasniqi - Në fakt, pjesa e parë e komenteve nuk kishte lidhje me mua dhe nuk ishte korrekte, sepse unë jam thirrur për të dhënë mendime për një draft. Mendimet me shkrim i kam paraqitur në mos gaboj, 12 adresime që nga viti 2017 kur ka nisur dhe i keni të gjitha në arkiv.

Kam mbajtur shënime dhe kam paraqitur pikat që lidhen me të. Çështja nuk është se unë jam kritik ndaj tyre, por për çdo pikë paraqita mendimin tim se ku janë pikat e dobëta dhe ku bëhet e prekshme kjo formulë dhe cenueshme. Unë besoj se për rrethanat ku ndodhet Shqipëria, parlamenti nuk arrin të krijojë besueshmëri që do të prodhojë një proces zgjedhor të drejtë, madje është në interesin tuaj që të kërkoni një alternativë tjetër. Ju keni thënë se pagat dhe privilegjet e komisionerit janë në privilegjet e kryetarit të Gjykatës së Lartë. Jepini statusin e njëjtë edhe për kriteret e zgjedhjes edhe anëtarit të Gjykatës së Lartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

... kryetarin e Gjykatës së Lartë pas një procesi të madh vetingu dhe kontrolli, kurse kjo është vendimmarrje direkt politike e parlamentit. Është proces krejt tjetër.

E përsëris, në Shqipërinë e pas disa viteve, administrata mund të jetë e besueshme dhe mund të jetë zgjidhje afatgjatë. Në Shqipërinë aktuale unë personalisht u besoj më shumë studentëve të Fakultetit Juridik sesa administratës publike, e, sidomos anëtarëve të partive politike, për shkak se, në fund fare, ne po flasim për një proces ku ka dy palë në konflikt, parti politike që votojnë dhe konkurrojnë në zgjedhje dhe njëra nga ato, në mos të dyja, janë të interesuara për të deformuar procesin. Nuk janë aktorët jashtë tyre. Çështja është si ta çlirojmë sistemin nga këto parti dhe jo të shkojmë të marrim vendime nga këto për sistemin e emërimit të kontrollorëve. Ky është problemi i madh i sistemit.

Në lidhje me anëtarësimin, Estonia, në mos gaboj ju duhet të keni qenë te vizita e fundit e NDI-së, është një nga vendet e Bashkimit Europian që ka bërë regjistrin kombëtar publik dhe çdo qytetar mund të verifikojë se kush është anëtar partie, sepse nuk kanë gjë për të fshehur. Për Shqipërinë kjo është shumë e hershme, por ka mekanizma prej nga mund të shkohet në këtë drejtim. Flasim për vende që kanë standarde shumë, shumë lart nga Shqipëria. Ndërsa në vendet me tranzicion ka mekanizma dhe ne duhet t'i gjejmë ato. Edhe Kosova e zgjidhi me anëtarët e Gjykatës së Lartë KQZ-në, për vite me radhë dhe vazhdon të

jetë një nga organet më të besuara në Kosovë dhe nuk është e kontestuar në vendimmarrjen e saj. Pra, edhe ne mund ta bëjmë këtë.

Në lidhje me anëtarët dhe strukturat më poshtë, këto janë çështje edhe teknike, nuk mendoj se, nëse ne shtojmë tavolina dhe anëtarë, të lidhet me shpejtësinë, por kjo lidhet me një lloj infrastrukture dhe sesi i zhvillojmë zgjedhjet për shkak të ndryshimit që u bë në atë kohë, që u numëruan votat në qendrat e votimit.

Lidhur edhe me sugjerimin e zotit Fino, të gjitha materialet do t'jua nis me shkrim.

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Krasniqi!

Fjala për zotin Murrizi.

Myslim Murrizi – Në kuadër të këtij bashkëbisedimi, duke i shtruar pyetje zotit Krasniqi, besoj që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gerta Meta - ...nuk është në qasjen tonë, kështu që do t'ju lutesha, që për arsye lehtësie ndoshta, dhe meqenëse jeni të lodhur e të ngarkuar për të gjithë situatën e kaluar të gjithë bashkë, e mira është që secili nga ne le të thotë gjënë e vetë dhe pastaj jemi shumë të hapur që ato merake që keni, t'i ndajmë bashkërisht.

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja Meta!

Fakti që ne e bëmë në këtë mënyrë, është se secili ka propozimet konkrete, të ndryshme nga tjetri dhe menduam që nëse anëtarët e komisionit kanë pyetje lidhur me propozimet, të kenë të drejtën të pyesin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjithsesi e mirëkuptoj kërkesën tuaj.

Zoti Murrizi, mund të vazhdoni dhe më pas do të vazhdojmë me përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Ju kërkoj ndjesë sërish për zgjatjen e kësaj seance, por besoj se është në shërbim të komisionit dhe qytetarëve që na ndjekin.

Myslim Murrizi – Mund të jetë e drejtë ajo që tha zonja, propozimet me shkrim ne i kemi këtu, por unë dua të sqaroj veten për ato që kam të paqarta nga propozimet me shkrim të shoqërisë civile dhe forcave të ndryshme politike, që të jem i qartë kur ta ngre dorën pro ose kundër lidhur me ato që kanë ardhur edhe nga ju, edhe nga ekspertët.

Jam plotësisht dakord me zotin Krasniqi, në Kuvendin e Shqipërisë janë emëruar punëtorë partie. Ndaj hingëllijnë këta si bejlerë, si pronarë, që ju i shihni si padrino që puthin qentë në qafë dhe bëjnë si shpëtimtarë të këtij kombi me shkop magjik.

E kam me zotin Krasniqi: miku im, ju thatë se 20% janë anëtarë të partive në të gjithë pjesën votuese, bëhet fjalë për 18 vjeç e sipër, apo jo. Shqipëria teorikisht ka 3 milionë e 600 mijë votues, pra kemi 720 mijë anëtarë partie si vend? Kjo ishte njëra nga pyetjet.

E dyta, ju dhe të gjitha organizmat e shoqërisë civile a keni bërë ndonjë sondazh lidhur me punonjësit e administratës, nga 150 mijë punonjës që ka administrata, 20 mijë me status të nëpunësit civil dhe 60-70 mijë janë në pushtetin lokal dhe pjesa tjetër janë pa status, sa për qind janë joanëtarë të partive politike? Se është bërë kriter në Shqipëri që nuk hyn në punë nëse nuk ke një dokument në xhep. Si mund të kemi besim tek administrata?

E treta, edhe nga ju, edhe nga ekspertët vura re që thatë se komisionerët e votimeve vjedhin votat dhe nuk janë ndëshkuar. E thoni se duhet thënë, apo e keni bindjen që komisionerët vërtet vjedhin votat? Unë vetë kam bindjen që vetëm 3 vetë vjedhin votat në Shqipëri, tri kryetarët e partive që kanë qeverisur Shqipërinë prej 30 vjetësh, ndërsa ata, atje poshtë, janë zbatues të urdhrave të kryetarëve. Ku ka komisioner që mund të guxojë të vjedhë vota, kur në Kodin Penal thuhet se të fusin në burg?! Po nuk u erdhi mesazhi në *Whats App* nga kapoja këtu në Tiranë, që u thotë hapni sytë tek ajo kutia atje, se po doli poshtë 60 %, ti nuk rri më as drejtor, as komandant! Si mund t'i frenojmë këta tri hajdutë që kanë vjedhur dhe duan sërish të vjedhin votat? Me pjesën tjetër të hallexhinjve nuk kemi punë.

Ju merrni çfarë të keni qejf komisionerë, ndoshta edhe studentë të juridikut, unë vetë jam dakord për mësuesit. Shqipëria ka 36 mijë arsimtarë, që janë pjesa më e frikshme me të drejtë ndaj ligjit, sepse janë me logjikë e dinë ta zbatojnë ligjin, ndryshe nga e gjithë administrata. Çoni 3 arsimtarë për qendër votimi, merrni ata të Lushnjës, çojini në Shkodër, ata të Shkodrës në Durrës, të Durrësit çojini në Elbasan dhe do të shikoni se s'do të vidhet asnjë votë. U thoni se do t'u bëhet sondazh kutive, gjithmonë nëse nuk japin urdhër kapot, sherifët këtu lart. 10 vjet burg, do të ikësh nga mësuesia, gjithë ata mësuesit e tjerë e kanë menduar që të dalin në pension, të marrin 300 mijë lekë e të tjera. Kush është ai që vjedh vota? Jo, votat janë vjedhur këtu, dhe janë vjedhur nga këtu ku jemi ne, e deri te parlamenti ku punojmë ne.

Kam pyetur edhe herën tjetër, cila është e vërteta që kjo plagë është majisur? Po, as unë nuk kam besim te parlamenti, se nuk ka parlament, janë *Whats App*-deputetë, si u shkon mesazhi, votojnë si manekinë. Pse? I kërcënon se nuk do të jenë më? Çfarë numri je këtë radhë ti? Këtë radhë Blerina ishte numri 6, ndërsa unë e çoj te 26-a dhe Blerina nuk hyn më. Ti, Myslim, çfarë numri ishe? Ishe 4, kurse unë të çoj te 14-a dhe nuk hyn më. Punëtor ore, punëtor. Nëse deputetët do t'i zgjedhin shqiptarët atëherë ata do të kenë më shumë dinjitet ata

dhe sa më shumë dinjitet të kenë ata aq më me dinjitet do t'i zgjidhen ata që do të varen nga ata atje. A kemi këtu të zgjedhur nga shqiptarët? Shqiptarët votojnë nuk zgjedhin, prej 3 palë zgjedhjesh dhe me detyrim-përcaktim. Është njëlloj si të shkosh në Sarandë dhe nuk ke menu dhe nuk ke çfarë të lexosh. Ke një pjatë çorbë të prishur dhe një pjatë supë me krimba, kështu që do hash ose njëërën, ose tjetrën. Kështu kanë ngrënë shqiptarët dhe prandaj tallen këta që rrokin qentë në qafë. A i keni parë këto ditë apo jo? Një hyn nga rruga këndeje fiku, ndërsa ai tjetri fishkëllen nga bahçja se me një shtëpi shkojnë. Unë kam pyetje, komente ose çfarë të duash ti o punëtor Kuvendi, sepse as ti nuk je deputet. Unë kam hallin se mos të japin urdhër të bësh tërmete...

(Diskutime pa mikrofon)

Mua nuk më japin urdhra, prandaj kam hallin tënd. U zgjodh prokurori dhe tashmë të shesin këta e të çojnë në burg...

(Diskutime pa mikrofon)

Dëgjo se çfarë po të them unë, se e ke dosjen në Peshkopi, ky është tërmeti i Zotit. Në fund të shesin këta, siç shitën kampionin, të çojnë në kokërr të burgut, pa mua më marrin opingat, prandaj hap sytë.

Zoti Krasniqi dua një përgjigje për anëtarët e partisë. A ka në administratë jo anëtar partie dhe nëse shikon ndonjë zgjidhje tjetër para se të shkojmë këtu apo ky është thelbi? I gjithë ky mosbesim që ke ti ndaj parlamentit, vënien në dorë të administratës e kanë sjellë komisionarët, sistemi apo 3 kapot që janë këtu?

Faleminderit!

Afrim Krasniqi – Për të respektuar kolegët materialet do t'jua dërgoj me shkrim dhe mendoj se aty do të marrësh edhe përgjigjen për tri pyetjet që bëre.

(Diskutime pa mikrofon)

Dua të jem korrekt...

(Diskutime pa mikrofon)

Kam përshtypjen që ndajmë shqetësime të përbashkëta...

Damian Gjikhuri – Myslim, të lutem, ka një radhë për të folur! Zotëria tha se pyetja juaj ishte e komplikuar, kështu që do t'jua nis me shkrim, historia mbyllet këtu.

Dua të jap edhe një koment lidhur me pretendimin e ngritur për zgjedhjen e anëtarëve nga gjyqësori, thjesht për t'iu kthyer kujtesës, sepse këtu në Shqipëri nuk gjejmë karar. Ne harrojmë që dikur ka pasur gjyqtarë që merreshin direkt me administrimin e votave, madje i shqyrtonin ankesat ose mund të ishin anëtarë të zonave zonale zgjedhore; kemi pasur Gjykatë

Kushtetuese që shqyrtonte ankesat zgjedhore; kemi pasur organe zgjedhore që zgjidhnin anëtarët e KQZ-së dhe prapë nuk gjetëm rehat nëse KQZ-ja ishte e pavarur apo jo. Këto formulat *Deus ex machina* i ke pasur para vitit 2000, kështu që mund ta kujtoni...

(Diskutime pa mikrofon)

Person – Vetëm në vitin 1991 kanë qenë...

Damian Gjijknuri – Jo, kanë qenë deri vonë, sepse i shqyrtonin gjykatat ankesat para Gjykatës Kushtetuese ishin të përfshirë. Organet e gjyqësorit kur bë Kushtetuta e re Këshilli i Lartë i Drejtësisë zgjidhte një pjesë të anëtarëve të KQZ-së dhe prapë u quajtën politike.

(Diskutime pa mikrofon)

Sa i takon pjesës së ankesave kanë qenë, numëroheshin votat madje. Kanë qenë gjykatat para se të shkonte te Gjykata Kushtetuese.

Rudina Hajdari – Zoti Alimadhi, fjalën e keni ju.

Më pas fjalën e ka zonja Meta. Më pas ekspertët do të kemi një reagim nga ana e tyre ndaj propozimeve të zotit Krasniqi apo në tërësi?

Unë mendoj më mirë t'ia japim fjalës zonjës Meta dhe më pas anëtarëve të tjerë.

Më pas do t'jua japim fjalën kur të bëhen të gjitha propozimet nga anëtarët e panelit.

(Diskutime pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi – Zoti Krasniqi, kam një pyetje për ju, pasi ju iu referuat idesë dhe mendimit të zotit Hyseni në lidhje me anëtarët e subjekteve politike. Për cilën parti e keni fjalën? Ju keni bërë një studim dhe dua të di se për cilën parti e keni fjalën? Ju më jeni drejtuar edhe mua, por nuk e kam pranuar, sepse më është dukur si prekje e lirive dhe të drejtave të njeriut. Unë kam 20 e ca vjet në politikë, edhe nëse kam deklaruar një subjekt tregtar që merret me politikë, këtij subjekti i shkrihet e gjithë pasuria. Për kë e keni bërë studimin ju, për PS, PD dhe LSI-në apo për subjekte të tjera?

Pashë se kishit një problematikë në vetvete sa u takon subjekteve të tjera. Po ta shogësh atë që kërkojmë ne sot, ndryshim të sistemit, ndërsa ju keni kapur gjithë sistemin, tani po vijmë tek e drejta, ndërsa ju thoni që këto subjekte politike kanë pasur privilegje e gjëra të tjera. Mbi çfarë baze e keni bërë studimin mbi anëtarët, mbi PS, PD dhe të tjerët?

Atë pjesën negative të...

(Diskutime pa mikrofon)

Afrim Krasniqi – Studimi është bazuar në të dhënat e partive parlamentare në vite dhe janë marrë më pas partitë parlamentare, përqindja e votave në vite duke u pjesëtuar me kuotën ligjore që parashikon ligji, që është minimale. Të dhënat zyrtare janë marrë me

shkresë zyrtare nga partitë politike, të cilat i janë përgjigjur dhe këto janë partitë parlamentare ndër vite.

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Krasniqi!

Adriatik Alimadhi – A keni ndonjë ide për funksionimin e partive politike, meqë e prekët pak anëtarësinë?

Rudina Hajdari – Zoti Fino, ju lutem, mos ndërhyini!

Zoti Rusmali, ju lutem, shkurtimisht!

Ilir Rusmali – Faleminderit, zonja bashkëkryetare!

Do të bëj shkurtimisht disa sqarime, sepse është e mira që gjërat të sqarohen pasi vërejtjet mund të përsëriten edhe nga të tjerët. Pse është zgjedhur Kuvendi organ emërtese? Kuvendi plotëson dy kritere. Kriteri i parë, është përfaqësues i sovranitetit popullor, gjëja që e harrojmë më parë të gjithë në Shqipëri. E dyta, Kuvendi është organi që jep llogari në mënyrë periodike dhe të domosdoshme në popull. Pra, do të thotë që këto janë dy kritere shumë të forta që e imponojnë këtë gjë. Në fakt, Kuvendi nga ana tjetër ka edhe një funksion të rëndësishëm se çështjet e demokracisë janë funksion i Kuvendit, KQZ-ja është institucioni që merret me demokracinë. Nga pikëpamja juridike është defekt i rëndë të krahasosh një institucion, qoftë edhe KQZ-në me një pushtet, pushtetin gjyqësor. Mekanizmat me të cilat ngrihet dhe funksionon pushteti gjyqësor janë të veçanta dhe të paimplementueshme tek të tjerët. Ky është një institucion i pavarur, i krahasueshëm me institucionet e tjera të pavarura që janë nën ombrellën e Kuvendit.

Rregullatori i ngritur mbi kritere selektive nuk është i vërtetë. Kriteret e përmendura aty nuk janë kumulative, e cila do të thotë se njerëzit që do të merren me hartimin dhe miratimin e normave duhet të jenë marrë në jetën e tyre të mëparshme me hartimin dhe miratimin e normave. Ka pasur draftues ligjesh apo të akteve nënligjore në pozicione të tilla që kanë bërë oponencën e ligjeve apo të akteve të nënligjore, apo ka pasur pozicione që janë marrë rregullisht me miratimin e akteve nënligjore, janë fusha me të cilat do të merren kur të bëhen anëtarë të rregullatorit dhe nuk janë pak, janë pa frikë me mijëra. Pra, vetëm nuk duhen parë, sepse duhet t'i kenë të tria kushtet bashkë. Të tria kushtet bashkë ndoshta nuk i ka asnjë njeri në Shqipëri.

Ka një keqkuptim lidhur me termin “funksionar politik”. Funkionar politik nuk është baraz me politikan, është term juridik i legjislacionit shqiptar. Në pishinën e funksionarëve politikë 95%, 99% po të doni ju, e njerëzve që kanë cilësinë e ish-funksionarit politik janë

teknicienë të nivelit të lartë në këtë vend, njerëzit më të mirë që ka prodhuar ky vend, secili sipas fushave përkatëse. Në ligj nuk ekzistojnë dy gjëra, pavarësisht se keqkuptohet.

E para, administrata publike nuk ka detyrimin për t'u bërë administrator zgjedhor, nuk ekziston detyrimi, por ka interesin për t'u bërë administrator zgjedhor.

(Diskutime pa mikrofon)

Lexojeni edhe një herë, nuk ekziston detyrimi. Dy gjëra nuk i bëjmë ne, fushën nuk e konsiderojmë si pjesë e të drejtës për punë, ka që e ngatërrojnë. Të jesh administrator nuk është punë dhe nuk është e drejtë që ty nuk mund ta mohojë njeri.

E dyta, detyrimi nuk ekziston, sepse do të binim ndesh me një dispozitë të rëndësishme kushtetuese, atë kundër punës së detyruar.

Administrata civile ka interes të ligjshëm për t'u angazhuar si administrator zgjedhor. Çfarë ka lidhje me teknologjinë dhe votimin nga jashtë nuk është kapitull dhe as dalje nga rekomandimet e ODIHR-it. Që të mundet KQZ-ja, siç sugjeroni ju, të merret me fushën, duhet ta ketë në ligj, sepse po nuk e pati kompetencë ligjore, nuk alodon dot asnjë cent për t'u marrë me këtë punë.

Pra, i duhet dhënë një kompetencë që të mund të angazhojë resurset e veta në fushën e studimit apo të hulumtimit të teknologjive...

(Diskutime pa mikrofon)

Po pra këtë i kemi dhënë kompetencën dhe jo m shumë se aq dhe nuk jemi larguar nga rekomandimet e ODIHR-it.

E fundit, referendumet janë aty. Kjo administratë është për referendumet dhe kjo është sot me ligj. Ligji që është në fuqi e ka administratën kompetente për referendumet, ngelet, pasi ne nuk mund ta ndryshojmë. Në kapituj që vijnë ndoshta mund ta forcojmë pak më shumë dhe ta përmendim më shpesh në mënyrë që të kuptohet nga të gjithë.

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Rusmali!

Fjalën e ka zonja Meta.

Më pas fjalën e ka zonja Gjirikondi.

Gerta Meta – Faleminderit!

Do të përpiqem të jem telegrafike për vetë faktin se gjërat këtu u konsumuan. Mendoj se drafti që është paraqitur duhet vlerësuar në parimin e përgjithshëm për vetë faktin dhe tendencën që ekspertët kanë pasur dhe në fund të fundit kemi një qasje tjetër në lidhje me depolitizimin e administratës zgjedhore si një shqetësim madhor, gjë që e kemi pasur gjatë gjithë proceseve zgjedhore në Shqipëri.

Natyrish, kur flitet për strukturën e re, e cila është gjë komplet tjetër nga ajo që jemi mësuar deri tani, ndoshta edhe merakun që zoti Kume apo edhe ne si kolegë të tij, si përfaqësues të shoqërisë civile, sa i takon pjesës së KQZ-së si një institucion i pavarur ose si një institucion kolegjial, në frymën dhe nga eksperiencia jonë, ka qenë që kolagjiliteti i këtij institucioni të vazhdonte për të qenë më i mbrojtur nga frustimi dhe presioni politik, i cili vazhdon të jetë evident në politikën shqiptare.

Fakti që aty ka edhe dy struktura të tjera, përveç komisionerit shtetëror, siç është ai rregullator dhe ai i CAS-it, apo komisioni për ankimin, shqyrtimin dhe sanksionet është diçka pozitive për të parë se jo gjithmonë të njëjtët vendosin për çdo gjë. Pjesa që kemi komisioner të rinj ku secili bën punën e tij, pra nuk janë të njëjtët që vendosin për të njëjtat gjëra nga fillimi i procesit deri në fund, është një qasje pozitive që duhet konsideruar në mënyrë që aty të jenë njerëzit e duhur dhe jo ata që i kanë marrë peng proceset zgjedhore në Shqipëri.

Pjesa që na bën ne si aktorë të shoqërisë civile të jemi pak skeptikë është fakti që këtu ka 2 ndarje. Këtu po diskutohet shumë se sa reale do të jetë pjesa e përfshirjes së administratës shtetërore dhe ndarja tjetër për qytetarët, të cilët nuk janë pjesë e shërbimit civil, po janë qytetarë të lirë, por edhe ata kanë të drejtën e tyre me një konkurrim të hapur të jenë pjesë.

Do të ishte mirë që starti për të marrë pjesë dhe për t'ua dhënë autoritetin qytetarëve shqiptarë si zyrtarë zgjedhorë të mos ishte kjo ndarje, meqenëse vazhdojmë ende të jemi peng i atij diskursi të fortë politik, që administrata shtetërore dhe publike për aq kohë që në Shqipëri partitë politike e kanë ende në mendësinë e tyre që sa herë ka rotacione politike edhe administrata ndryshon, kjo është pjesa që kemi merak.

Pra, për aq kohë sa do të kemi një administratë që nuk ndërrohet apo zëvendësohet, në të cilën nuk do të jenë evidentë militantët, por profesionistët, starti të jetë njësoj për të gjithë ata qytetarë që do ta marrin dhe në fund do të jenë të autorizuar për të qenë zyrtarë zgjedhorë. Të mos ketë thjesht një ndarje ku do të kemi një thes të njerëzve që do të zgjidhen me short nga administrata dhe qytetarë të thjeshtë që nuk janë të angazhuar.

Pyetja që unë kam është: pse vetëm nga sektori publik dhe jo nga sektori privat, sektori i shoqërisë civile? Pjesa e trajnimeve që do të bëhet për këtë kontingjent që do të jenë zyrtarë zgjedhorë të jetë hapur jo vetëm nga komisioni qendror, ndoshta të ketë hapësirë dhe një trajnim *online*, përqindja mund të jetë diskutueshme te 75% apo diçka më e ulët, duke i dhënë një akses më të madh që njerëzit ta kuptojnë se çfarë do të thotë zyrtar zgjedhor dhe

pse është e rëndësishme që ata të jenë aty për të respektuar ligjin dhe jo për të krijuar problematika në kontestimin e proceseve zgjedhore në vazhdimësi.

Gjithashtu, merakut tjetër që ne kemi është se aty thuhet se nëpunësit civilë të të gjitha niveleve e kanë detyrimin. Kjo, për ne si organizatë, na duket si diçka që duhet kritikuar, pasi ka një koretacion militaresk, ushtarak, jo detyrim. Pse detyrim? Është një koncept që duket sikur i detyron njerëzit me një aksion dhe me një goditje të përqendruar, por çështja është se kjo vazhdon më tej ku thuhet: refuzimi pa shkak të ligjshëm. Përsëri vazhdon ideja e konceptit ushtarak ku kushdo ka të drejtë të mos e marrë përsipër një detyrim. Mendoj se te kjo pjesë duhet të shprehemi pak më mirë ose të krijojmë një ide që, për të shërbyer si zyrtar zgjedhor, braktisja e detyrës së caktuar, cenimi i parimit të paanësisë politike e të tjera, të gjitha këto formojnë shkak të ligjshëm për largimin e nëpunësit nga shërbimi civil me të gjitha procedurat e dhënies së masës nga sistemi i apelimit të proceseve administrative dhe gjyqësore referuar ligjit “Për shërbimin civil”. Këto ishin disa komente dhe shqetësime që ne kishim në lidhje me amendamentet që janë bërë për nëpunësit civil.

Ne duam një përgjigje nga ekspertët dhe të na sqarojnë se përse administrata shtetërore është burimi kryesor në lidhje me targetin që ata janë të autorizuar për të qenë zyrtarë zgjedhorë në një kohë që kjo mund të jetë një lojë e hapur? Ju e dini shumë mirë që partitë politike, meqenëse këtu u diskutua që janë të mbyllura në lidhje me deklarimin dhe listën e anëtarësive, le ta bëjnë publike në mënyrë që edhe njerëzit ta dinë nëse janë apo jo anëtarë dhe të kujt partie janë dhe kjo do ta lehtësonte edhe pjesën e përzgjedhjes së zyrtarit zgjedhor, duke pasur edhe këtë listë publike nga ana e partive politike, gjithmonë duke shpresuar se ata do ta bëjnë për ta ndihmuar procesin.

Unë mendoj që loja të jetë e hapur jo vetëm për administratën publike, por për të gjithë sektorët.

(Diskutime pa mikrofon)

Fakti që jemi të shqetësuar tregon që...

(Diskutime pa mikrofon)

Për aq sa e kemi lexuar...

(Diskutime pa mikrofon)

Nëse ju na e konfirmoni që loja është e hapur për të gjithë, atëherë nuk ka pse të ndahet në dy thasë: administratë publike dhe qytetarë të thjeshtë, vëreni startin njësoj për të gjithë. Ky është merakut që kemi.

(Diskutime pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Ju lutem, pa ndërhyrje!

Zonja Gjickondi, fjala për ju.

Zoti Tase, do ta merrni fjalën pas zonjës Gjickondi.

Brizida Gjickondi – Është hera ime e parë që vij në komision. Megjithëse i kam parë edhe ndryshimet e para që janë bërë me aktin e parë, do të kërkoja diçka nga bashkëkryetarët, nga zonja Hajdari dhe zoti Gjicknuri, po të jetë e mundur, po e them me shumë elegancë, të evitojmë qasjen dhe të komunikuarin autoritar që kanë anëtarët e komisionit ndaj neve, anëtarëve të shoqërisë civile, kur japim opsionet ose mendimet tona, pasi gjatë gjithë kohës që jam këtu, vërej se ka një sjellje autoritare. Ndoshta kjo vjen edhe ngaqë i keni karriget më lart se ne, ndërsa ne i kemi disi më poshtë, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe nga zoti Fino, edhe nga zonja Gjylameti pashë një sjellje...

(Deputeti Fino ndërhyr pa mikrofon.)

Jo, jo, absolutisht, unë mendoj që ne këtu jemi të gjithë për një kauzë dhe që nga momenti kur ne kemi ardhur këtu tregon se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo ishte diçka që e kisha vetë, zonja Hajdari, që mënyra e komunikimit të jetë pak më bashkëpunuese me të gjithë ne.

E dyta, i kam përgatitur me shkrim të gjitha pretendimet dhe sugjerimet e mia, por pa marrë disa përgjigje këtu sot nuk mund t’jua dërgoja me *e-mail*, sepse më duheshin disa përgjigje nga ju përpara se t’i dërgoja, që t’i dorëzoj tamam, pra të bëj diçka serioze, sepse nuk mund të paragjykoj diçka që mund të marr përgjigje këtu dhe nuk është nevoja ta shkruaj.

Kisha një pyetje për ekspertët, e cila ndoshta mund të jetë pak profane dhe disi e trashë, por unë do të doja një përgjigje. Duke qenë se ju keni prekur organin kryesor që ka Kodi Zgjedhor, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (komplet strukturën e tij), madje nuk jam dakord me atë që u tha më përpara. Në nenin 12, që është ndryshuar në pikën 2, thuhet tekstualisht: “Komisioneri është një organ monokratik”, domethënë ka një titullar, nuk është më kolegjal.

Unë dua të di: me këtë prekje të thelbit që i keni bërë Kodit Zgjedhor, a nuk mendoni se do të ishte më mirë të bëhej një Kod Zgjedhor i tërë? Sepse keni prekur të gjithë strukturën që mban sistemi zgjedhor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, të prekësh kolonën mbajtëse të të gjithë ligjit dhe të mos ndryshosh Kodin Zgjedhor, madje edhe ndryshimet që keni bërë para një muaji dhe që i kam këtu (për barazinë gjinore e të tjera)...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptoj, por gjykoj se nuk përbën sens të prekësh organin kryesor mbajtës të procedurës dhe të mos bësh të gjithë Kodin Zgjedhor. Kështu i bie që arnat të jenë më të mëdha sesa fustani. Domethënë, këto janë arna. Pra, nuk ka më sens që ju të bëni të gjithë këtë punë. Kjo ishte pyetja e parë.

Pyetja e dytë, duke qenë se në sistemin e parë ishte zoti Islami, i cili ishte frymëzuar nga sistemi spanjoll, nga jeni frymëzuar ju për këtë lloj sistemi që keni sjellë në Shqipëri? Në çfarë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, për ndryshimin e institucionit.

Në rast se mund ta di, do të isha shumë e nderuar, pasi dua të di edhe nga jeni frymëzuar, për të pasur edhe unë një ide tjetër se si do të zbatohet kjo gjë. Sepse, mirë, mund ta shkruash në letër, por puna është sa do të jetë e zbatueshme, si do të bëhet... Pra, nga sistemi zgjedhor i cilit shtet jeni frymëzuar që ka afërsi me mënyrën si funksionon Shqipëria, që ne mund ta marrim si model dhe vërtet mund të rezultojë i suksesshëm?

Tjetër pyetje: a nuk mendoni se heqja e Komisionit Qendror Zgjedhor nga Kushtetuta, gjë që për mua është skandaloze, sepse të kesh në Kushtetutë një institucion si Avokati i Popullit, për të cilin nuk kam ndonjë konsideratë shumë të lartë në punën që po bën lidhur me situatën që është në Shqipëri, ose Kontrolli i Lartë i Shtetit, që për mua edhe ai përdoret gjithnjë politikisht për të goditur armikun e radhës është një vakuum i madh? Pikërisht edhe kjo bën që ky vakuum të ketë probleme dhe ju mund të bëni çfarë të doni, duke qenë se është fusha bosh. Nuk e kam për ju të dy, të kuptohemi, e kam për ju, si juristë të shquar të fushës: a nuk mendoni se kjo gjë mund të bëhet abuzive nga politikanët e radhës për të abuzuar?

Unë nuk kam parë kushtetuta të tjera, por, po të shikosh edhe kushtetutat e vendeve të Europës, shprehen për institucionin që administron zgjedhjet, ndërsa në Kushtetutën e Shqipërisë nuk kemi asnjë rresht. Personalisht, mendoj se kjo nuk ka qenë pa dashje, por është bërë me dashje që Kodin Zgjedhor ta bëjnë si të duan dy anët e politikës.

Kam edhe pyetje të tjera, por mendoj që një Kod Zgjedhor dhe amendamentet e bëra duhet të mënjahohen disi nga klishetë ku përmendet, për shembull: “Paga e rregullatorëve është sa gjysma e pagës mujore të komisionerit”. Një ligj duhet të jetë shumë serioz dhe

duhet të ketë vetëm koncentrat të gjërave, ose të jetë vërtet elitar. Këto gjëra mund të dalin me akte nënligjore. Ose, për shembull, edhe kur thuhet: “Paga dhe privilegjet e komisionerit janë të njëjta me pagën dhe privilegjet e kryetarit të Gjykatës së Lartë, unë u tmerrova, sepse si mund të përmendësh në ligj privilegje, paga?! Mund të thuhet vetëm kaq që statusi i atij është i njëjtë me statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Nuk ke pse të hysh...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam edhe çështje të tjera, por po i përmend shkurtimisht.

Ju keni thënë që për zgjedhjen e anëtarit në përgjithësi, dhe jo vetëm të Komisionit të Ankimeve dhe të Sanksioneve shumë përzgjedhje anëtarësh bëhen në bazë të eksperiencës së mëparshme të suksesshme. Kush e mat suksesin? Cili është organi që e mat suksesin?

Gjithashtu, kur shikoj edhe këtë që zgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë, përsëri shkoj tek ajo që Kuvendi i Shqipërisë nuk ka atë sovranitet dhe atë përfaqësim të drejtpërdrejtë që i jep Kushtetuta... Patjetër, ju do të luani me letrat që keni!

(Zoti Rusmali ndërhyr pa mikrofon.)

Po, profesor, po!

Unë i pashë kompetencat e komisionerit dhe, ngaqë jemi bërë me hije, kur pashë germën “e”: “Komisioneri lidh marrëveshje, kontrata me të tretët e të tjera”, unë mendoj që më mirë ta kishte me kolegjalitet lidhjen e kontratave, të tenderëve e të tjera, sepse... Ne jse, unë do t’i dorëzoj këto edhe me shkrim, zoti Rusmali.

Kam edhe një pyetje të fundit, duke qenë se e kam pak merak pjesën e gjuhës shqipe. Te neni 25/2 ju keni shkruar: “Qartësimi i zyrtarëve zgjedhorë”. Sipas etimologjisë, qartësimi është folje kalimtare dhe nuk përdoret. Madje, po ta përkthesh sipas etimologjisë, domethënë e bën diçka të duket më mirë. Mendoj se duhet të gjeni diçka më zyrtare dhe, sipas teknikës legislative, diçka nga gjuha shqipe që i shkon fiks kësaj gjëje. Unë nuk i kam hyrë thelbit të kësaj, sepse unë vazhdoj të mbetem te pyetjet e para: pse e morët këtë model? Nga u frymëzuat? A keni bashkëpunuar me anëtarët e KQZ-së aktuale dhe a keni ndonjë raport, ose një pasqyrim të dështimeve që ju bënë të ndryshoni gjithçka nga e para? A keni menduar që Kodi Zgjedhor duhet të ndryshojë në tërësi, duke prekur sidomos sistemin zgjedhor, që, për mendimin tim, është koka e të gjitha problemeve dhe jo këto që po rregullohen?

Për mua, dhe kjo është e fundit, tregon se ka një mosbesim të klasës politike me njëra-tjetrën, prandaj bëhen gjithë këto arna, jo se vërtet Shqipëria nuk ka ecur përpara prej mosrespektimit ose prej politizimit.

Sa për politizimin, unë pashë që në kodin e mëparshëm thuhej që deri pesë vjet përpara nuk duhej të kishe qenë pjesë e asnjë partie politike, ndërsa në kodin e tanishëm, që keni ofruar ju, është hequr fare kjo klauzolë.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja Gjirkondi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjijnuri – Ilir, ta dëgjojmë edhe zotërinë dhe pastaj bëjmë një përmbledhje!

Rudina Hajdari – Po, zoti Tase, fjala është për ju.

Erjon Tase – Faleminderit!

Në fakt, tani në fund ka humbur pak a shumë durimi dhe vëmendja, ndaj do të shtoj tri pyetje ose pikëpyetje shkurtimisht.

Draftin e ardhur do ta vlerësoja, pasi është vazhdim i punës së dy ekspertëve që kanë qenë që nga viti 2018. Ne kemi paraqitur rekomandimet në emër të Akademisë së Studimeve Politike. Këtu kam dokumentin e marsit të vitit 2018. Për fat të mirë, rekomandimi ynë i parë, që ka qenë certifikimi i detyrueshëm i të gjithë trupës zgjedhore, pavarësisht se nga vijinë, është përfshirë, qoftë edhe në variantin e shtatorit të vitit 2018, atëherë pa e përfshirë administratën publike, por duke mbajtur edhe idenë e komisionerëve aktualë, por thjesht të jenë të trajnuar, të përgatitur. Në vijim të kësaj, pavarësisht punës pozitive, që ne e vlerësojmë, unë do të thosha që edhe pjesa e përfshirë në këtë draft (administrata publike), aktualisht, me sa kuptojmë, nuk është ndaluar që të jenë përsëri funksionarët aktualë, pra ato komisionerë që janë caktuar edhe nga partitë, edhe që kanë abuzuar deri sot. I vetmi kushtëzim është që të mos jenë të dënuar dhe të mos jenë ushtarakë, policë... Këto janë kufizimet e vetme për të qenë komisioner. Kështu që kjo hije që diskutohet këtu dhe kjo ideja që po bëhet diçka shumë e madhe për Shqipërinë, që do të jetë administrata publike, në njëfarë mënyre mund të rezultojë se do të jenë përsëri komisionerët aktualë, thjesht nuk do të jenë partitë politike që do t'i caktojnë në zona të caktuara, por do të jenë me short.

Pikëpyetja ime është: si do të jetë raporti në rast se vijinë përsëri komisionerë partiakë që të trajnohen, të certifikohen, të jenë brenda standardit dhe ata që janë në administratë publike? Do të jetë raporti kur të hidhet shorti, apo kujt do që do t'i bjerë gogla?

Së dyti, çështja e krijimit të strukturave të reja: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator dhe Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve. Pak a shumë, ne dimë

se forma e një institucioni publik, ku KQZ-ja të funksionojë si një institucion publik, gjë që është e pranueshme në të gjithë vendet e botës, në Shqipëri ka pasur gjithnjë skepticizëm, por shpresojmë të ketë një administratë zgjedhore që të jetë sa më institucionale. Meraku ose shqetësimi që vjen, sepse, sigurisht, nga eksperiencat e deritanishme unë e shikoj paksa të rrezikshme që mund të kapet Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS-i), i cili përbëhet nga tre anëtarë (mund të zgjidhet nga parlamenti, në rast se nuk plotësohen tre të pestat e votave qoftë edhe me një short), ku mund të kandidojë kushdo që është ish-gjyqtar, ish-anëtar KQZ-je dhe ish-nëpunës i nivelit të lartë drejtues. A mos do të ishte më mirë të kishim ose një numër më të madh, ose për standard një kriter për të siguruar disa persona, të cilët nuk do të rrinë aty nëntë vjet për një mandat nëntëvjeçar, por do të kapen nga pushteti?

Dua të kujtoj edhe mënyrën se si është përcaktuar edhe për komisionerin, për kryetarin e KQZ-së, edhe për anëtarët e komisioneve të tjera, që keni parashikuar vetëm të jenë “ish-”: ish-politikanë, ish-zyrtarë administrate, ish-OJF. Këta persona nuk duhet të japin as dorëheqjen, në rast se merret që e kanë dhënë për t’u zgjedhur këtu. Domethënë, i bie që do të kemi disa...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kandidatët, për të qenë në pozicione drejtuese ose anëtarë të këtyre tri komisioneve të rëndësishme, nuk duhet të kenë dhënë as dorëheqjen kohët e fundit, kështu thuhet, për të kandiduar. Atëherë, do të kemi disa kandidatura që do të jenë të paaftë, do të jenë pa punë, duhet të jenë patjetër njerëz që ndoshta janë larguar edhe nga shërbimi civil? Mund të jetë dikush që mund të jetë shumë i aftë në shërbimin civil dhe që vazhdon punën. Pse është parashikuar që duhet të jetë patjetër “ish-”? Ky ishte meraku im.

E parafundit, pa dashur të zgjatem, ndoshta duhet të përcaktohen më mirë edhe kriteret e edukimit dhe eksperiencës së punës për këta persona: të kenë një formim juridik, pra formim në një fushë të caktuar, që të arrijë të gjykojë edhe vendimet.

E fundit, një tjetër rekomandim yni, ai numër dy, është të shikohet edhe një herë mundësia që Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve të shqyrtojë edhe ankesat e qytetarëve të cilëve u mohohet vota. Është e lejuar që ta ankimojë një parti politike, një kandidat, por jo një person. Madje, sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike, ku Shqipëria është pjesë, edhe një person, edhe një votues ka të drejtën të kërkojë ankimimin, në rast se i shkelet e drejta e votës, pra kur nuk i lejohet të votojë.

Do t’i dorëzoj edhe me shkrim, por shpresoj të reflektohen, meqenëse është krijuar një komision ankesash dhe ankimimi nuk është lënë më thjesht në gjykatë.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Tase, në radhë të parë, për durimin që treguat, sepse ishit i fundit që prezantuat!

Dua të reagoj pak në lidhje me kërkesën që zonja Gjikondi kishte për bashkëkryetarët. Zonja Gjikondi, edhe pse, në fakt, personalisht nuk më pëlqen gjuha autoritare, nuk e përcaktoj dot në gjuhën e deputetëve, sepse ne kemi një rregullore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Deputetët janë institucion më vete; ata votohen. Kështu që është në dorën e votuesve të votojnë atë që duan dhe më pas deputetët flasin...

Patjetër, unë mund të kërkoj nga deputetët dhe nga anëtarët e komisionit të jenë sa më bashkëpunues dhe, në fakt, kjo është fryma që ne kërkojmë. Nëse kam një këshillë për ju, në fakt, është që ju duhet të kishit ardhur këtu me propozime konkrete, jo me pyetje ndaj ekspertëve. Në fund të fundit, do të jemi ne ata që do të votojnë. Fakti se kemi thirrur shoqërinë civile është pikërisht për të na dhënë opsione të tjera në lidhje me draftin që ka ardhur nga ekspertët. Pra, në mënyrë që drafti të pasurohet, ne duam mendimin tuaj që të bindemi për draftin që do të votojmë. Pra, t'i marrim parasysh propozimet që do të bëni ju në mënyrë konkrete. Unë mendoj se ju jeni ekspertë dhe e dini shumë mirë se çfarë do të thotë gjuha e shkruar mbi draftin dhe se çfarë do të thotë çdo nen i propozuar nga ekspertët, pra jeni në gjendje të jepni propozimet tuaja në lidhje me këto nene që janë renditur këtu.

Të mos bëjmë debat me ekspertët, pasi jam e sigurt që të dyja palët mund të kenë të drejtën e tyre për mënyrën se si i bëjnë propozimet e tyre, por, sinqerisht, do të donim shumë, duke marrë parasysh rolin e gjithsecilit... Në fund do të jetë pikërisht parlamenti që do të votojë këtë draft. Ndaj, në mënyrë që ne të kemi një punë sa më frytdhënëse, duhej të kishim disa propozime më konkrete.

Ju thatë në fillim se keni bërë disa pyetje dhe i jeni drejtuar Kuvendit. Nuk e di nëse u jeni drejtuar ekspertëve dhe ata nuk kanë qenë në gjendje të japin përgjigje, nëse ka qenë momenti kur kemi pasur krizën e tërmetit dhe nuk kemi qenë në gjendje t'ju japim përgjigje në kohë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjithsesi, mendoj se është e rëndësishme që ne të kemi këtu propozime, sepse vërtet do të na ndihmonin jashtëzakonisht shumë, sidomos në këto momente kur ne vërtet duam të kemi një Kod Zgjedhor ndryshe, pra me një lloj ristrukturimi tërësor, që do ta ndryshojë

komplet arkitekturën e administratës zgjedhore. Prandaj donim vërtet disa propozime në lidhje me pikat që kanë propozuar ekspertët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, të mos e kthejmë në debat!

Brizida Gjikondi – Nuk e kthej në debat, thjesht dua të them që...

Rudina Hajdari – Unë do t'ua jap fjalën ekspertëve në lidhje me pyetjet që ju kishit.

Brizida Gjikondi – ...nuk mund të shkruhen propozimet pa pasur dy-tri përgjigje që unë i kam thelbësore. Nesër do t'i keni të gjitha propozimet me shkrim.

Rudina Hajdari – Dakord. Ndoshta pas përgjigjeve të ekspertëve mund të vini me disa propozime konkrete dhe të na i depozitoni në Kuvend.

Brizida Gjikondi – Faleminderit!

Rudina Hajdari – Fjalën e ka Gjylameti, për të vijuar më pas me reagimin e ekspertëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Blerina Gjylameti – Një sekondë, ju lutem!

Së pari, nëse ndonjëri nga përfaqësuesit është ndier i fyer, unë ju kërkoj shumë ndjesë, nuk ishte fare në qëllimin tim, as të përdorja një gjuhë autoritare dhe më pak intimiduese apo për të treguar nivele të ndryshme!

Fakti që jeni këtu është një vlerësim maksimal ndaj punës që bëni dhe unë, personalisht, por besoj se edhe anëtarët e komisionit, vlerësojmë çfarëdolloj mendimi, kushdo qoftë ai, për çdo gjë që bëni!

Besoj që ndër vite bashkëpunimi, qoftë nëpërmjet parlamentit dhe organizatave joqeveritare, ka qenë i tillë që kemi arritur deri në njëfarë niveli.

Ajo që unë desha të thosha kishte të bënte me thirrjen për të mos vazhduar ende me përgjithësime, sepse këto të fundit na kanë sjellë në pikën ku jemi. Jo vetëm mosfunksionimi i institucioneve, por edhe përgjithësimet që bëjmë. Për këtë gjë ishte edhe kërkesa ime ndaj asaj që u tha deri në atë moment.

Si dikush që politikës i është bashkëngjitur pak më vonë sesa keni ju eksperiencë me organizatat, besoj se duhet ta ndryshojmë mënyrën e të folurit, të të komunikuarit, qoftë të të akuzuarit apo edhe të propozimit të ndryshimeve, pasi besoj që në njëfarë pike mosbesimi ndaj institucioneve ka arritur majat në Shqipëri. Kjo që ka ndodhur nuk i bën nder askujt. Nuk besoj se është faji juaj, por nuk besoj as që është faji vetëm i këtij krahut këtej. Ndaj edhe e kisha kërkesë për ju.

I kërkoj ndjesë edhe një herë kujtdo është ndier i fyer apo i intimiduar, apo edhe për gjuhën autoritare; nuk e pata qëllim.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Fjalën e ka zoti Alimadhi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe zonja Hysi e kërkon fjalën për pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, qetësi!

Adriatik Alimadhi – Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino!

Në fakt, keni ngritur një problem shumë të drejtë: ankimimi i subjekteve politike pranë Komisionit Qendror ose, në qoftë se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prisni, se unë do t'ju jap një rast! Në kohën e zotit Ristani, ne kishim 147 vota, ndërsa PSD-ja e Gjijnushit kishte 143 vota. Ia bashkëngjitëm provat, ia çuam KQZ-së, e cila na i rrëzoi poshtë. Fakti thoshte se mandatin e merrnim ne me 147, por mandatin e merrte ajo që kishte më pak. Pra, nuk i mori provat parasysh. Unë kam një kërkesë për ekspertët në këtë rast, nuk po dëgjoni, sepse nuk ju intereson juve; vendoseni në lista. Pra, të gjitha ankimimet që bëhen nga subjektet politike, sepse roli, në fund të fundit, i KQZ-së ose i emërtesës tjetër që do të gjendet, mendoj që të hapen dhe të merren parasysh. Pra, jo vetëm për individët, por edhe për subjektet politike, sepse, në fund të fundit, subjektet politike janë një kontributore ndaj kësaj, por edhe KQZ-ja që kryen punën dhe paguhet me taksat e të gjithëve ta hapë këtë dhe ta zgjidhë këtë të drejtë, ta vendosë në tavolinë. Unë kam një mendim që të gjitha subjektet politike ose edhe personat fizikë në këtë rast që bëjnë ankimime, KQZ-j t'i hap dhe t'i shqyrtojë ato, se ka dalë, ne kemi kolegë këtu, që kanë votuar atje dhe nuk u ka dalë vota. Pra, mendoj se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të gjitha ankimimet që bëhen, të vendosë që të hapen dhe të shikohet çdo padrejtësi që ka.

Kaq kisha, zonja Hajdari.

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Atëherë, fjala për zotin Rusmali.

Ilir Rusmajli – Faleminderit, zonja bashkëkryetare!

Në lidhje me pyetjen, nëse duhet, për shkak se ndërhyrja është në themelin e ligjit, është e vërtetë që ndërhyrja është në themelin e ligjit dhe, për pasojë, ndërhyrja është masive. Pra, do të prekë shumicën e dispozitave. Kështu që krahasimi juaj me fustanin dhe arnat, ndoshta duhen shtuar edhe pak arna dhe duhet krijuar imagjinata e saktë.

Nëse duhet ligji i ri apo jo, nuk është gjykimi i ekspertëve. Nuk e themi dot ne. Ne kemi pasur në punën që kemi bërë kufizimin që kanë qenë rekomandimet e OSBE-ODIHR-it. Për shkak të rekomandimeve, kemi prekur administrimin, më pas administrimi ribën gjithçka, sepse është kudo, është kapilar. Në qoftë se ky komision do të gjykojë për një ligj të ri do të ulemi të gjithë bashkërisht, do të punojmë për një ligj të ri. Në qoftë se do të gjykohet që nuk është ende momenti, sepse është edhe arsytim politik, nuk e gjykojmë dot ne situatën politike, por e gjykojnë ata që janë në politikë, mund të zgjidhet një moment tjetër pak më vonë. Do të pranojnë që në një moment pak më vonë të bëhet ky proces, por ndërhyrja do të ngelet masive.

Në lidhje me pyetjen për modelin: është gjithmonë legjitime dhe është po aq *tricky*, duhet ta pranojmë këtë. Pyetja për modelin bëhet kryesisht me nëntekstin e mosbesimit. E ke shpikur, nuk është gjë, e ke marr model të gatshëm, është i mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di fare mirë që nuk është në arsyetimin tënd kjo, por duhet ta pranojmë se ka gjithmonë një lloj debati të tillë për modelin. Modeli nuk është kurrë kopje. Në qoftë se është kopje, është gabim dhe për këtë biem dakord. Domethënë, modeli duhet të jetë burim frymëzimi dhe më pas atë frymëzim që të jep modeli, e përshtat me situatën e vendit.

Në lidhje me mënyrën se si e kemi formuar KQZ-në, ne i kemi dhënë sqarimet tona para komisionit dhe besoj se janë publike. Pjesa dërmuese e praktikës së institucioneve shqiptare ka lidhje me këtë model. Janë institucione monokratike dhe janë trupa kolegjiale vetëm kur ka vendimmarrje të rëndësishme, pra në rastin tonë vendimmarrje normative, por institucionet janë monokratike. Gjykata Administrative, si trupë e veçantë. Ke një listë institucionesh shqiptare që kanë një komision apelimi ose që kanë një trupë administrative që është jashtë titullarit dhe gjykon ankimimet e nivelit administrativ. Pra, këtë gjë e kemi. Kemi modele jashtë shtetit. Më i afërti që kishim ne për lehtësi ishte modeli i panelit të ankimimeve të Kosovës, që formohet si një trupë jashtë institucionit dhe gjykon me pavarësinë e një trupe jashtë institucionit. Pothuajse kudo ku shkon, e gjen këtë model. Me përjashtim të KQZ-së

shqiptare, e cila është formuar si një model *sui generis* në kohën e saj dhe më pas ka prodhuar disa kopje në Shqipëri që të gjitha të dështuara. Pra, organ kolegjal permanent. Nuk ka funksion si organ kolegjal permanent, por janë njerëz që ose rrinë papunë, sepse nuk kanë detyra administrative, funksione administrative, ose shfrytëzojnë pozicionin dhe mbledhjen për të bërë sherret e nivelit administrativ që nuk janë kompetencë e tyre, kompetenca e tyre është vendimmarrja. Kjo është analizë e përgjithshme, jo konkretisht. Analiza është kjo: organet kolegjiale ekzistojnë në botë, por janë krejt të tjera nga këto. Organet kolegjiale permanente janë trupa që formohen nga drejtuesit e strukturave të brendshme të institucionit. Një ditë në muaj mblidhen drejtorët me kryedrejtorin dhe marrin vendime që i përkasin fushës, vendime, rregulla dhe norma i bëjnë bashkë, por është gjë tjetër, nuk ka lidhje me mënyrën se si i kemi formuar organet tona kolegjiale permanente. Ndërsa ky model që ne kemi, është kudo ku do të hedhësh sytë do ta gjesh këtë model dhe e ke shumë të kollajshme për ta gjetur, pavarësisht se duket atipik, sepse jemi mësuar të shikojmë atë që kemi ende parasysh.

Debati në lidhje me heqjen e KQZ-së nga Kushtetuta, dhe mendoj se ndoshta që është mirë që të propozojmë të rivihet. Personalisht kam një rezervë në raport me këtë, ky është opinion personal, nuk kam çfarë të them. Zgjidhja që u bë për të vendosur KQZ-në në Kushtetutë ishte zgjidhja atipike dhe efekti i vetëm që pati nga pikëpamja kushtetuese ishte se dëmtoi aktin themelor, nuk e forcoi institucionin, përkundrazi, e dëmtoi aktin themelor. Pse? Sepse ditën kur politika kërkoi të shrinte më gjerë, ta çonte më gjerë hapësirën e saj në institucion u bë papritur një amendament kushtetues. Domethënë, iu vu viza aktit themelor për dy nene. Pse? Sepse duhej të shtoheshin dy veta. U dëmtua Kushtetuta, nuk u përmirësua institucioni, sepse nuk u bë për interesin e institucionit, u bë për të kënaqur interesat politike të palëve të përfaqësuara atje. Kështu që nga kjo pikëpamje ndoshta fakti që nuk është në Kushtetutë, është një avantazh sot, sepse ndoshta sot ka mundësi për t'u rregulluar më mirë, pa pasur nevojë të ndryshosh Kushtetutën. Vullneti i mirë është për ta rregulluar. tani ju e gjykoni nëse po e rregullohet apo po prishet, por vullneti është për ta rregulluar.

Në lidhje me vendosjen e pagave dhe privilegjeve si formulim, pra si term, Ajo është në ligjin aktual dhe është e tillë në ligjin aktual dhe është edhe në këtë masë shpërblimi në ligjin aktual. Në vetvete kategoria është e rëndësishme, sepse ka lidhje me pavarësinë e institucionit. Është një nga instrumentet kryesore të pavarësisë. Ne këtë e kemi dëgjuar sa herë flasim për pavarësinë e gjyqësorit: rrogat-rrogat... Pra, për mua është kriter formal dhe

jo i rëndësishëm, por është stabilizuar si i tillë, se ndihmojë pavarësinë e institucionit një pagë dhe disa privilegje, të cilat nuk mund të preken me vendime qeverie.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ke të drejtë, mund të shprehej, vetëm do të na duhej vetëm të krahasonim në detaje statusin, sepse mund t'i jepnim ndonjë gjë që mund të ishte gabim, sepse duhej të krahasohej me detaje statusi me statusin e gjyqësorit për të parë më pas.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam një pyetje: kush e mat suksesin? Suksesin e kujt?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, atyre që kanë qenë?

Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Zonja Gjykondi dhe zoti Tasi, a doni t'u përgjigjeni pyetjeve të komisionit, meqenëse kemi pyetje nga anëtarët e komisionit për ju, apo nuk do të preferonit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mendova se kishit mbaruar, zoti Rusmali. Ju kërkoj ndjesë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Bashkim Fino -...se nuk kuptoj. Nuk e quaj kohë të humbur, pavarësisht se kam që në mëngjes në parlament, votuam buxhetin, as drekë nuk kemi ngrënë dhe po vazhdojmë. Nuk e kam për këtë, se mund të bënim pushim bashkëkryetarët.

Problemi është që në dosjen time kam një material, të cilin ju si ekspertë të OSBE/ODIHR-it na e keni sjellë. Dëgjova partitë politike, dëgjova shoqërinë civile, pavarësisht se si u etiketua, bëmë edhe ne pyetje për mendimet e sugjerimet e tyre, ashtu siç bënë edhe ata pyetje për ju. Në rastin konkret unë jam duke dëgjuar mësim tregues tani.

Ajo që unë do të doja të dija si anëtar komisioni, që të veproj nesër, është nëse do të kemi apo jo një draft komplementar me mendimet dhe sugjerimet e shoqërisë civile dhe të partive politike, të këtij drafti që na keni bërë ju, që na i keni sjellë në kuadrin e përgjithshëm, që të veprojmë, sepse ne nuk rrimë kot të dëgjojmë këtu. Apo kjo është thjesht për të bërë një diskutim midis shoqërisë civile dhe juve si ekspertë, gjë që personalisht mund të mos më interesojë? Mua më intereson se çfarë do të kem te ky draft, pra nëse mendimet e sugjerimet që dhanë ata do të pasqyrohen apo jo këtu.

E kam më tepër për bashkëkryetarët pyetjen, nuk e kam për ju. Çfarë do të bëhet nesër? Ne kaluam gjithë këtë kohë dhe vendimmarrjen do ta marrim prapë ne, duam apo nuk duam, pavarësisht se këta nuk kanë ndonjë qejf të madh të votojmë ne si parlament, por ne e kemi këtë të drejtë dhe ne do ta kemi vendimmarrjen.

A do të kemi ndonjë draft, ndonjë material nga kolegët e nderuar që ishin këtu dhe folën, që t'i krahasojmë dhe më pas t'u kërkojmë ekspertëve ndonjë mendim apo sugjerim? E kam me ju, nuk e kam me ekspertët.

Rudina Hajdari – Zoti Fino, unë thashë pothuajse të njëjtën gjë para se t'ia jepja fjalën zotit Rusmali, sepse nuk doja të kthehej në një bashkëbisedim midis ekspertëve dhe...

Ju mund të bëni një bisedë, të depozitoni pyetje dhe më pas të merrni përgjigje, por ne duhet të kemi propozime konkrete këtu, në mënyrë që të veprojmë për një draft nesër, që ta votojmë në parlament.

Prandaj, do të doja të mos vazhdonim me këtë bashkëbisedim midis njëri-tjetrit, por ndoshta të gjenit një moment tjetër apo të shkëmbenit *e-mail*-et me njëri-tjetrin dhe të sqaroheshit për pyetjet që kanë anëtarët e shoqërisë civile.

Zoti Rusmali, nëse...

Illir Rusmajli – Zonja bashkëkryetare, në përgjigjet tona nuk ka asnjë gjë që ju nuk e dini. Ju i dini të gjitha këto që do t'u themi atyre. Kështu që është më se e drejtë ajo që thoni ju. Ne mund të ulemi me kolegë, se kolegë jemi, dhe mund të bisedojmë me ta jashtë kësaj tryeze. Nuk ka nevojë që komisioni të dëgjojë përgjigje të cilat i di, sepse janë dhënë disa herë.

Rudina Hajdari – Kërkoj mirëkuptimin tuaj, sepse kemi pasur një ditë shumë të gjatë dhe të ngarkuar.

Zoti Fino, ndërhyrja ishte e saktë dhe ju kërkoj ndjesë, sepse dita vërtet ka qenë shumë gjatë!

Ju falënderoj shumë për prezantimin, që erdhët sot në Komisionin e Reformës Zgjedhore dhe dhatë propozimet tuaja!

Falënderoj zotin Kume, zotin Krasniqi, zonjën Gjikondi dhe zotin Tase, që erdhën këtu!

Falënderoj ekspertët dhe anëtarët e Komisionit të Reformës Zgjedhore!

Dua t'ia jap fjalën zotit Gjikhuri për të...

Damian Gjikhuri - Edhe unë dua t'ju falënderoj, por nisur edhe nga sugjerimet e fundit, dua t'ju them se pavarësisht se ky komision shfrytëzohet edhe si platformë idesh, mbi

të gjitha, ky është komision pune! Ju këtë punë e bëni mirë edhe në studiot televizive dhe shumë ide tuajat janë prezente në çdo familje (ata që ju ndjekin), por duke qenë se ne jemi të fokusuar te këto drafte, që nuk themi se janë më të mirat, të përgatitura nga ekspertët, do të donim që ju të jepni propozime mbi to dhe kjo tavolinë të mos kthehej thjesht në një platformë idesh se si mund të jetë idealja apo më e mira. Përkundrazi, nisur nga çka kemi shkruar aty mund të propozoni dhe të jepni sugjerimet tuaja.

E gjej me vend atë që tha edhe Rusmali. Mbase do të ishte mirë një takim i ekspertëve me përfaqësues të shoqërisë civile për shpjegime të mëtejshme. Këtë mund ta koordinoni edhe me sekretarinë e komisionit. Pra, të jetë një takim pune ku ekspertët e shoqërisë civile, së bashku me ekspertët, të jenë një tavolinë të rrumbullakët pa praninë e medieve, për të sqaruar të gjitha pyetjet dhe sugjerimet që kanë.

Dakord? A do ta bëjmë këtë? Mirë është të bëhet sa më shpejt, në fillim të javës. Mund të koordinoni një datë në sekretari, mund të mblidheni në Kuvend apo diku tjetër dhe...

(Deputetja Vasilika Hysi ndërhyr pa mikrofon)

Kush të dojë nga deputetët. E mira është të mblidhen përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe ekspertët për të gjitha pyetjet që u ngritën këtu, se çfarë modelesh keni nisur dhe çfarë ka që nuk shkon, shqetësimet nisur edhe nga eksperiencia.

Në fund të fundit, këto debate nganjëherë janë më të mira në nivel ekspertësh sesa këtu, sepse shpeshherë po pati medie dhe tryezë partish politike, zakonisht kthehet në platformë idesh sesa në një platformë të vërtetë pune.

Edhe unë ju falënderoj shumë!

Do të shihemi shumë shpejt për trajtimin e kapitujve të ardhës!

MBYLLET MBLEDHJA